

GJYKATA E APELIT – PRISHTINË

Lënda: AC.nr.3560/2012

Data: 5 dhjetor 2013

GJYKATA E APELIT - PRISHTINË në shkallë të dytë përmes trupit gjykues të përbërë prej Gjyqtarës Civile të EULEX-it ROSITZA BUZOVA, si Kryetare e Kolegjit, Gjyqtari MUHAMED REXHA dhe Gjyqtari MUHARREM SHALA, si anëtarë të kolegjit;

Në lëndën civile të paditësit JC nga Suhareka, tani me vendbanim në Beograd, Serbi, përfaqësuar nga Avokati RB kundër të paditurve “BA” Sh.P.K.-Suharekë, përfaqësuar nga BK – Pronar dhe Drejtor, KOMUNA e Suharekës, përfaqësuar nga SG- avokat publik komunal, dhe GA nga Suhareka për “vërtetim të së drejtës së apartamentit”;

Pas pranimit të ankesës së parashtruar nga Avokati RB në emër të JC, paditës në shkallë të parë, ankues në shkallë të dytë, kundër aktvendimit C.nr.28/2011 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 30 maj 2012;

Pas këshillimit dhe votimit në seancë të mbyllur të trupit gjykues të mbajtur sipas Nenit 190, paragrafi 1, hipoteza e parë në lidhje me Nenin 208 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare Nr. 38/08), e ndryshuar dhe e plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/12) (“LPK”) më 5 dhjetor 2013;

Me anë të kësaj, sipas Nenit 209, paragrafi 1, pika d) e LPK lëshon si në vijim

A K T V E N D I M

Ankesa e paditësit JC, nga Suhareka, tani me vendbanim në Beograd, Serbi, e parashtruar nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, Avokati RB më 28 qershor 2012 me anë të kësaj MIRATOHET dhe aktvendimi C.nr.28/2011 i Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 30 maj 2012 ANULOHEM me kthim i lëndës në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim.

A R S Y E T I M

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 11 shkurt 2011, JC nga Suhareka, tani me vendbanim në Beograd, Serbi, si paditës parashtroi kundër Ndërmarrjes “BA” - Suharekë, përfaqësuar nga pronari i saj BK, KOMUNA e Suharekës dhe GA nga Suhareka si të paditur padi Gjykatës Komunale të Suharekës. Paditësi pretendoi të jetë zotërues i të drejtës së banimit, që

do të thotë të drejtën për të poseduar apartamentin në Suharekë, në Rr. “Car Dušan” Nr.59, hyrja 1, apartamenti nr. 5, kati II, me sipërfaqe prej 41 m², e dëshmuar nga Vendimi HPCC/D/233/2005/C, i datës 16 dhjetor 2005 dhe Vendimi HPCC/REC/76/2006, i datës 18 tetor 2006, i lëshuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (“KKPB/HPCC”). Pas ndërtimit të këtij apartamenti, ishte demoluar në pranverë të vitit 2010, një i ri ishte ndërtuar në ngastrën e njëjtë. Padiësi tentoi të informoj të paditurin e parë për të drejtat e tij në apartament në ndërtesën e re, bazuar në atë të cilën e kishte në atë të demoluarën, por ishte refuzuar çdo kontakt. Ai i dërgoi një paralajmërim me shkrim të paditurit të dytë por pa rezultat. Ndërkohë, një apartament i tillë i ri iu ishte ndarë të paditurit të tretë, megjithatë ai në mënyrë të paligjshme e përdorte apartamentin e vjetër dhe dështoi në procedurë të HPCC. Më tej, padiësi i referohet të drejtës për të respektuar banesën e tij e garantuar nga Neni 8, paragrafi 1 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“KEDNJ/ECHR”) dhe mungesës së ndonjë arsytimi sipas Neni 8, paragrafi 2 i KEDNJ për ndërhyrje të autoriteteve publike në ushtrim të kësaj të drejte që mund të arsyetoj refuzimin e saj. Në *petitum* është kërkuar nga Kolegji të obligoj të paditurin e parë dhe të dytë t’i ofrojnë padiësit apartamentin në ndërtesën e re të ndërtuar në Suharekë, në Rr. “Car Dušan” nr.59, me sipërfaqe prej 41 m², apo t’i kompensoj atij me vlerën e saj të tregut, si dhe të urdhëroj të paditurin e tretë të prit përmbushjen e këtyre obligimeve brenda 15 ditëve pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Padia ishte regjistruar për gjykim në C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës.

2. Më datën 7 prill 2011, GA parashtrroi përgjigjen e tij në padi, duke e kontestuar në tërësi atë me kërkesat që kolegji të refuzonte atë si të palejueshme apo të refuzoj atë si të pabazuar. Kundërshtimet e bëra janë që padiësi nuk është i legjitimuar për të kërkuar vërtetimin e të drejtës në shfrytëzim mbi apartamentin në Suharekë, në Rr. “Dëshmoret e kombit” në ndërtesën e ish postës me sipërfaqe prej 41.16 m² pasi që e drejta e njëjtë i përket GA në pajtim me aktgjykimin e formës së prerë C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006.

3. Më datën 13 prill 2011, KOMUNA e Suharekës parashtrroi përgjigjen e saj në padinë, duke kontestuar në tërësi atë dhe duke kërkuar refuzimin e saj si të pabazuar. Ky i paditur ceku që para demolimit të ndërtesës në Suharekë, në Rr. “Car Dušan” nr.59 të gjitha informatat e disponueshme për pronarët dhe shfrytëzuesit e objektit në të ishte marrë. Në këtë proces GA dëshmoi të drejtën e tij mbi shfrytëzim të apartamentit të kontestuar me aktgjykimin e formës së prerë C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006, ndërsa JC nuk paraqiti prova të vlefshme. Prandaj, në bazë të këtij të padituri, kontesti nuk ka mundur të vendoset dy

herë nga gjykata, duke qenë i zgjidhur në aktgjykimi i formës së prerë të sipërpërmendur, obligative për të gjitha institucionet, vendore dhe ndërkombëtare.

4. Më 19 prill 2011, “BA” SH.P.K. iu përgjigj padisë duke mohuar legjitimitetin pasiv pasi që sipas Nenit 6, paragrafi 4 i Marrëveshjes së lidhur më 27 gusht 2008, KOMUNA e Suharekës duhej të përcaktonte pronarëve dhe shfrytëzuesve të apartamenteve në ndërtesë të vjetër, dhe t’u ndante atyre objektet ekuivalente në ndërtesë të re. “BA” SH.P.K. hoqi dorë nga çdo obligim në lidhje me kthimin e banuesve të mëhershëm, lëshimin e vendimeve mbi ndarjen në emër të tyre dhe bartje të pronësisë në apartamentet e reja.

5. Me aktvendimin C.nr.28/11 të Gjykatës Themelore të Suharekës, të datës 30 maj 2012, padia e JC ishte hedhur poshtë si e palejueshme pasi që objekti i deklaratës së tij ishte gjykuar tashmë (*res judicata*), duke urdhëruar çdo palë të bart shpenzimet e veta të procedurës. Në arsyetim, rrjedha e procedurës së shkallës së parë ishte përmbledhur. Ishte përsëritur shpjegimi i përfaqësuesit të paditësit në seancën preliminare për padinë në C.nr.28/11 duke qenë e parashtruar për apartament të njëjtë sikurse ai i vendosur në aktgjykimin C.nr.100/2006 të Gjykatës Komonale të Suharekës, të datës 19.05.2006. Në bazë të këtij sqarimi duke vendosur kundërshtimin *res judicata* të të paditurit të dytë dhe gjithashtu duke vepruar *ex officio*, gjykata e shkallës së parë arriti në përfundim që padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme sipas Nenit 166, paragrafi 2 i LPK si “*çështje – lënda e kontestit është vendosur nga aktgjykimi C.nr. 100/06 të Gjykatës Komonale në Suharekë, të datës 19 maj 2006, e formës së prerë prej datës 26 qershor 2006.*”

6. Aktvendimi C.nr.28/11 i Gjykatës Komonale të Suharekës, të datës 30 maj 2012 ishte dorëzuar sipas Nenit 110, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së të gjitha palëve, përfshirë paditësit më 8 qershor 2012.

7. Më datën 22 qershor 2012, Avokati RB dërgoi me postë një ankesë në emër të paditësit JC në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër aktvendimit C.nr.28/2011 të Gjykatës Komonale të Suharekës, të datës 30 maj 2012, duke e kundërshtuar atë në bazë të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore – Neni 181, paragrafi 1, pika a) në lidhje me Nenin 208 të LPK-së, vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike – Neni 181, paragrafi 1, pika b) në lidhje me Nenin 208 të LPK-së dhe aplikim të gabuar të ligjit të së drejtës materiale – Neni 181, paragrafi 1, pika c) në lidhje me Nenin 208 të LPK-së. Kërkesa në gjykatë të shkallës së dytë të anulohet dhe aktvendimi me kthim të lëndës në gjykatë të shkallës së parë për ri-gjykim.

8. Në pajtim me Nenin 187, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 208 të LPK, ndonëse kopjet e kësaj ankese iu janë dorëzuar ankuesve, por asnjë përgjigje nuk është dorëzuar brenda 7 ditëve të afatit ligjor. Kështu që, sipas Nenit 188, paragrafi 1, në lidhje me Nenin 208 të LPK më 23 korrik 2012 ankesa me dosje është dërguar në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe është regjistruar si AC.nr.323/12. Duke qenë e pa përfunduar më 31 dhjetor 2012, sipas rregullës kalimtare të Nenit 39, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-199 mbi Gjykatat (Gazeta Zyrtare Nr. 49/11) kjo lëndë civile e shkallës së dytë është bërë më 1 janar 2013 lëndë e Gjykatës së Apelit, e regjistruar sërish nën numër e dosjes së re – AC.nr.3560/12.

9. Me vendimin me nr.ref.2013.OPEJ.0321-001 të Nën Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 16 korrik 2013, AC.nr.3560/12 e Gjykatës së Apelit, ishte marrë nga EULEX-i dhe iu ishte caktuar një kolegji ankimor prej tre gjyqtarëve në pajtim me Nenin 5, paragrafi 1, pika c), paragrafët 4, 5 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Kryetarit të Kolegjit, Gjyqtarit Civil të EULEX-it iu ishte caktuar nga Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it Vendimi me nr.ref.2013.OPEJ.0321-001, të datës 16 korrik 2013. Gjyqtarët kosovarë – anëtarët e kolegjit ishin caktuar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit me Vendimin AGJ. I.nr.306/2013, të datës 19 korrik 2013.

10. Duke qenë në përbërje ligjore në pajtim me kriteret e specifikuara të nenit 5, paragrafët 1, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, ky kolegji i Gjykatës së Apelit është i autorizuar të vendos AC.nr.3560/12 bazuar në kompetencën e përgjithshme të shkallës së dytë në lëndët civile sipas Nenit 15, paragrafi 2 i LPK dhe Nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-199 mbi Gjykatat.

II. LEJUESHMËRIA E ANKESËS DHE PROCEDURËS SË SHKALLËS SË DYTË

11. Nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për gjykim të ankesës. Në vend të parë, aktvendimi i ankimuar duke qenë për hedhje poshtë të padisë sipas Nenit 387, paragrafi 1, pika w), Neni 166, paragrafi 2 dhe Neni 391, pika d) të LPK-së është i ankimuar bazuar në pikën e përgjithshme të Nenit 206, paragrafi 1 i LPK-së përderisa nuk ka ndonjë dispozitë që e ndalon këtë mjet juridik kundër asaj. Në vend të dytë, ankesa nuk është e vonuar sipas Nenit 186, paragrafi 2 në lidhje me Nenin 210 të LPK-së. Aktvendimi C.nr. 28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 30 maj 2006 iu ishte dorëzuar përfaqësuesit të paditësit sipas Nenit 118, paragrafi 1, fjalia e

parë e LPK-së më 8 qershor 2012. Ankesa e tij iu ishte dërguar me postë më 22 qershor 2012 datë e cila sipas Nenit 127, paragrafi 2, fjalia e parë e LPK-së duhet të konsiderohet ajo e dorëzimit në gjykatë. Në pajtim me Nenin 127, paragrafi 1 i LPK-së ajo ishte dorëzuar në kohën e rregullt para skadimit të afatit kohor prej 15 ditëve të paraparë nga Neni 176, paragrafi 1, fjalia e parë në lidhje me Nenin 208 të LPK-së më 23 qershor 2012. *Në vend të tretë*, nuk është e palejueshme sipas Nenit 186, paragrafi 3 në lidhje me Nenin 208 të LPK-së. Ishte dorëzuar nga Avokati RB si përfaqësues i paditësit, i autorizuar me autorizim, të datës 6 mars 2012. Ankuesi duke qenë palë në shkallë të parë ka të drejtën procedurale dhe gjithashtu interes juridik të ankimoj aktvendimin për anulim të tij. Asnjë heqje dorë nga e drejta në ankesë apo tërheqje të ankesës sipas Nenit 177 në lidhje me Nenin 208 të LPK-së nuk ishte deklaruar nga kjo palë. *Në vend të katërt*, ankesa ka parakushtet e Nenit 178, pikat a) – d) në lidhje me Nenin 208 të LPK-së; përmbajtja e saj *nuk është jo e pa përfunduar* sipas Nenit 179, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 208 të LPK-së. Prandaj, nuk ka baza ligjore për palejueshmëri të ankesës dhe të procedurës së shkallës së dytë të iniciuar nga ajo.

III. SHQYRTIMI ANKIMOR I AKTVENDIMIT TË KUNDËRSHTUAR TË SHKALLËS SË PARË

12. Brenda shqyrtimit ankimor, shkalla e dytë do të shqyrtoj aktvendimin e ankimuar mbi bazat e treguara në ankesë, si dhe *ex officio* për shkeljen/shkeljet e paraqitura në Nenin 194 në lidhje me Nenin 208 të LPK-së.

Shkelje Thelbësore Procedurale e Nenit 166, paragrafi 2 i LPK-së

13. Me aktvendimin e ankimuar C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 30 maj 2012, padia e JC ishte *“hedhur poshtë si e palejueshme duke pasur si objekt çështjen e deklaratës së tij të gjykuar”*. Neni 166, paragrafi 2 i LPK-së ishte baza e vetme ligjore e aplikuar për hedhje poshtë të padisë *res judicata* me anulim të procedurës pa mbështetje në ndonjë dispozitë tjetër.

Res judicata – karakteristikat e përgjithshme, funksionet dhe kufijtë

14. Mbrojtja kundër dublikimit të përcaktimit të procedurës për të drejta civile është një nga mbrojtjet specifike të shoqëruara me garanci të përgjithshme të së drejtës mbi gjykimin e drejtë sipas Nenit 6, paragrafi 1, fjalia e parë e KEDNJ, drejtpërdrejt e aplikuar në Kosovë sipas Nenit 22 të Kushtetutës. Qëllimi është për të ndaluar përsëritjen e një procedure të tillë që është përfunduar nga një vendim përfundimtar – atë që ka fuqinë e *res judicata* kur është i pa kthyeshëm sipas mjeteve

juridike të zakonshme sepse palët kanë shfrytëzuar ato apo kanë lejuar kufijtë kohorë për të skaduar pa i shërbyer atyre për aplikim të tyre (*Nikitin v. Russia*, nr. 50178/99, § 37, ECHR/KEDNJ 2004-VIII). Aktgjykimi bëhet *res judicata*, kur është i formës së prerë, i pa ankimuar, dhe përndryshe ligjërish i pakthyeshëm nën ligjin vendor. Në logjikën e kundërt, aktgjykimi nuk është i formës së prerë për qëllimet e *res judicata* kur ankimohej apo afatet kohore për përmirësim të ankesës nuk kanë skaduar (*Blečić v. Croatia*, nr. 59532/00, ECHR 2004-VIII). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“ECHR/GJEDNJ”) ka deklaruar në të drejtën sipas praktikës së mëparshme që *e drejta në gjykim të drejtë*, e interpretuar në bazë të parimeve fundamentale të sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike, rumbullakon kriterin ku gjykatat përfundimisht kanë përcaktuar çështjen, vendimin e tyre mos të vihet në pyetje (*Brumărescu v. Romania*, nr.28342/95, § 61, ECHR 1999-VII; *Kondrashov v. Russia*, nr. 2068/03, § 27, ECHR). Aspekti *përsëritës* i seancave dhe/apo aktgjykimit / aktgjykimeve i shpallur në ato është qendror në këtë aspekt – nuk ka mundur të ketë shkelje të *së drejtës së gjyqimit të drejtë* apo në përgjithësi apo *e drejta në gjykatë*, ku dy pjesët e procedurës *nuk janë kumulative* në një padi të vetme (*Nikitin v. Russia*, nr. 50178/99, § 35, ECHR 2004 - VIII).

15. Në të vërtetë *res judicata* është një nga pasojat kryesore ligjore të prodhuara nga secili aktgjykim i pa ankimuar, pa marrë parasysh llojin e padisë dhe rezultatit të lëndës. Parimi dikton që ku shqyrtohet kontesti civil mbi meritat nga gjykatat, ajo duhet të vendoset një herë dhe për të gjithë. Ajo sintetizon mbrojtjen e aprovuar dhe sanksionin e caktuar në procedurë Kontestimore për të ruajtur të drejtat materiale subjektive, të prekura nga kontesti. Sidoqoftë, ai nuk krijon këto të drejta, e as nuk mundet të barazohet me ligj në lëndë. Në bazë të parimit të ligjshmërisë të bashkëlidhur në Nenin 2, paragrafi 2 i LPK, *res judicata* në vetë është e bazuar në ligj, nënrendon në të gjitha kriteret e saja, vetëm kthimin e efektit rregullues ai ka në rrethanat e kontestueshme. Së këndejmi, *res judicata* nuk mund të kthej pronën e paluajtshme – asnjë aktgjykim deklarativ sipas Nenit 254, paragrafi 1 i LPK-së e bën jo ekzistuese një të drejtë apo një lidhje juridike ekzistuese dhe *anasjelltas*. *Res judicata* nuk është supozim ligjor i pakundërshtueshëm për vërtetësinë e asaj çfarë është deklaruar apo përcaktuar në aktgjykim. Pozitivisht ai obligon palët dhe të gjithë institucionet publike të marrin parasysh dhe të respektojnë atë; negativisht ai ndalon gjykatën, nëse një herë merret përsëri me kontest të njëjtë, për të vendosur atë në bazë të meritave (*non bis in idem*).

16. Në bazë të funksionit mbrojtës që procedura kontestimore ushtron mbi të drejtën materiale në kontest gjyqësor, *res judicata* përmban së pari dhe në mënyrë

kryesore në obligim të *palëve* t'i jap fund kontestit të zgjidhur. Përveç me mjete juridike të jashtëzakonshme, nëse janë në dispozicion, askush nga ata nuk mundet në mënyrë zyrtare të kundërshtoj ajo që është bërë *res judicata*. Megjithatë, janë *vetëm palët në rastin e vendosur konkret* që e kanë këtë obligim – ato duhet të respektojnë këtë gjendje të përcaktueshmërisë dhe pa kontestueshmërisë sikurse që është paraqitur *ndërmjet atyre*, dhe jo *erga omnes*. Vendimi përfundimtar duke qenë obligative për *palët* është bazë për sjelljen e tyre të ardhshme dhe të përbashkët të tyre në çështjen *res judicata*, dhe *anasjelltas* duke qenë jo obligative për *personat e tretë* nuk është e lejueshme të prodhoj këtë efekt juridik rregullues në ato si mos pjesëmarrës në kontestin gjyqësor të përfunduar. Këta kufij bartin komponentin tjetër kryesor të *res judicata* – mos zgjidhshmërinë e atij kontesti të zgjidhur. Duke qenë i obliguar për mos kontestim të çështjes së vendosur të dyja palët, por vetëm palët në mënyrë të barabartë humbin të drejtën *materiale* – që është lëndë e *res judicata* të drejtën *procedurale* për të pretenduar atë në një procedurë të re. Duke qenë absolutisht *parakusht procedural në mënyrë negative*, e bën të papranueshme çdo padi vijuese dublikate pasi që ajo është *ex lege* e përfunduar nga *res judicata* e formuar me përfundim të vendimit gjyqësor në padi tashmë të zgjidhur kryesore/originale. Kështu, *res judicata* përbën pengesë procedurale për çdo seancë *de novo* ndërmjet palëve të njëjta në kontest të njëjtë. Kjo mbrojtje e pa zbërthyeshme *res judicata* nga rreziku i të pasurit një vendim kontradiktor në padinë e re të parashtruar së fundi, duke mbuluar njëra tjetrën në elementet thelbësore atë tashmë të gjykuar.

17. Jurisprudenca e KEDNJ tashmë ka njohur si të pajtueshme me Nenin 6, paragrafi 1 i KEDNJ kufijtë ekzistues në të gjitha sistemet ekzistuese për efektin *res judicata ad personam* dhe sa i përket fushëveprimit material (*Kehaya v. Bulgaria, nr. 47797/99 dhe 68698/01, § 66, 12 janar 2006; Esertas v. Lithuania, nr.50208/06, § 22, 31 gusht 2012*). Si pasojë, aktgjykimet e formës së prerë konsiderohen penguese vetëm për ri shqyrtimin e kontestit të njëjtë ndërmjet palëve të njëjta. Në të kundërtën, ato nuk janë përfundimtare për kontestet në lëndë të njëjtë ndërmjet palëve apo ndërmjet palëve të njëjta në çështje lëndore të ndryshme. Për të përmbledhur, *res judicata*, pa marrë parasysh për intensitetin e saj, është shumë *absolute* por e kufizuar në ndikim të saj, duke pasur të dyja një fushëveprim të kufizuar *ad personam* dhe një fushëveprim lëndor të kufizuar (përveç për kategoritë e veçanta të aktgjykimeve, sikur ato në statusin civil, obligative *erga omnes*).

18. Këta kufij *res judicata* janë të pandara në këtë procedurë gjyqësore civile. Në pajtim me Nenin 2, paragrafi 1 i LPK-së gjykata në procedurë kontestimore vendos *brenda fushëveprimit të padive të paraqitura nga palët ndërgjyqëse*. Sipas Nenit 166,

paragrafi 1 i LPK-së aktgjykimi që nuk mund të ankimohet do të bëhet i formës së prerë *vetëm në lidhje me atë që është vendosur nga aktgjykimi në padi dhe kundërpadi*. Bazuar në Nenin 167, paragrafi 1 i LPK-së *aktgjykimi i formës së prerë prodhon efekt juridik vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse*, përveç kur nga shkaku i natyrës së raportit kontestues apo, sipas urdhrimit të ligjit, prodhon efekt kundër palëve të treta. Neni 167, paragrafi 2 i LPK-së e zgjeron përfundimin e aktgjykimit në *gjendjen e raportit juridik në kohën e shqyrtimit të seancës kryesore*. Neni 166, paragrafi 2 i LPK duhet të aplikohet jo i izoluar por sistematikisht lexo të gjitha këto norma të cilat e rregullojnë formën e prerë të aktgjykimit dhe pasojave të tij. Rrjedhimisht, Jurisprudenca e Kosovës ka qenë gjithmonë jo e diskutueshme që çështja është *res judicata* vetëm nëse në mënyrë kumulative ekziston *identiteti subjektiv* – ngjashëm deklarata e padisë dhe ngjashmëria e bazës faktike të saj, sikurse është vendosur në rast të parë dhe sikurse është në pritje në çdo rast vijues.

19. Kufijtë objekti të *res judicata* – kjo është çështje lëndore për të cilën aplikohet *res judicata* – e drejta materiale në të cilën gjykata ka vendosur, duke miratuar apo refuzuar atë sipas Nenit 252 të LPK-së. Nëse fushëveprimi i padisë është në përputhje dhe nuk ka tejkaluar aktgjykimin, *res judicata* e saj korrespondon me çështjen lëndore të rastit – kështu *do të vendosen çështjet ndihmëse dhe kryesore* sipas Nenit 166, paragrafi 2 i LPK-së është i vlefshëm për këtë çështje *res judicata* - e drejta e kontestueshme materiale, e vendosur në dispozitiv sipas Nenit 160, paragrafi 3 i LPK-së, dhe e individualizuar në të nga përmbajtja e saj, titullari, klasifikimi ligjor, madhësia, etj. Neni 166, paragrafi 3 i LPK-së paraqet vetëm përjashtimin në këtë çështje, duke vazhduar *res judicata* në vendimin të përfshirë në dispozitiv sipas Nenit 160, paragrafi 3 i LPK-së në të drejtën e të paditurit për kompensim në padinë e paditësit të paraqitur nga *prapësimi i dërguar* në procedurë pa kundërpadi. Përveç këtyre kufijve objektiv nuk është formuar *res judicata*, ndërsa pengesa e Nenit 166, paragrafi 2 i LPK-së nuk vepron.

20. Kufijtë e përkohshëm të *res judicata* – siç është përcaktuar qartë nga Neni 167, paragrafi 2 i LPK-së forma e prerë e aktgjykimit lidhet për gjendjen e raportit juridik *në kohën e përfundimit të shqyrtimit kryesor* sipas Nenit 436 të LPK-së. Ky është momenti me rëndësi prej të cilit gjykata përcakton nëse e drejta e kontestueshme ekziston apo jo. Kjo është arsyeja nëse është konfirmuar me *res judicata*, nuk ka mundur më vonë të ankimohet nga faktet që kanë ndodhur para këtij momenti. Ndërsa, *res judicata* përcakton raportin juridik, nuk ka mundur të pengoj zhvillimin e saj të ardhshëm, dhe nuk e ngrinë gjendjen e tij. Në të dyja faktikisht dhe ligjërisht të gjitha ndryshimet të cilat ndodhin pas datës së përfundimit të seancës kryesore nuk

kanë mundur të merren parasysh nga gjykata, dhe kështu që *res judicata* është formuar nga aktgjykimi i saj dhe në mënyrë të mundshme nuk i mbulon ato. E pashuar nga ajo, këto fakte të ndodhura së fundi mund të shërbejnë si bazë për padi të lejueshme të re duke iu referuar periudhës së të drejtës së kontestueshme, duke arritur sukses, dhe duke mos proceduar *res judicata*.

21. Kufijtë subjektiv të *res judicata* – ato përshkruajnë rrethin e personave që nuk mundën të ankimojnë të drejtën e vërtetuar juridike si ekzistuese apo për të pretenduar ligjërisht të drejtën e mohuar si jo ekzistuese, duke qenë të obliguar të vërtetojnë sjelljen e tyre të ardhshme me gjendjen juridike në fund të përcaktuar nga gjykata. Këta janë personat të lidhur me *res judicata*; sa i përket atyre *res judicata* është e vlefshme; ata janë *res judicata* të adresuarit ligjor. Rrethi i këtyre personave, sidoqoftë, nuk është i pakufizuar. *res judicata* nuk është e vlefshëm *erga omnes* – në të kundërtën, edhe pse shumë intensive, si rregull *gjendja e tij juridike prodhohet ndërmjet palëve ndërgjyqës në këtë rast*. Neni 167, paragrafi 1 i LPK është i qartë në atë pikë pa dykuptimësi. Ky është një kufizim i drejtë. Vetëm *palët* kanë pasur rastin në procedurë të paraqesin fakte, të përmendin provat dhe të kërkojnë argumente ligjore, kështu duke ndikuar përmbajtjen e aktgjykimit. Në kontrast, *personat e tretë* të cilët nuk marrin pjesë në lëndë kanë pasur rast procedural zero për të bërë përpjekje çdo ndikim në rezultatin e tij. Aktgjykimi mund të jetë me gabim i nxjerrë – veç kësaj, ai mund të jetë si rezultat i seancës simuluese. Nëse personat e tretë i nënshtrohen *res judicata* të tij, ata do të arrin në kompromis në mënyrë jo të arsyeshme, dhe rastet simuluese do të stimulohen. Kështu çdo kush që dëshiron që në mënyrë të duhur të pranoj të drejtën mundet lirshëm të padis një të paditur të zgjedhur të paligjshëm për të marr aktgjykimin, që zyrtarisht mundet të hyj në fuqi si i kundërshtueshëm në titullarin real të së drejtës. Për të shmangur këtë në tërësi, rezultati i papranueshëm i Neni 167, paragrafi 1 i LPK-së kufizon ndikimin juridik të aktgjykimit të formës së prerë tek ndërgjyqësit në lëndë vetëm. Me këtë kusht norma do të thotë *palët kundërshtare* në procedurë – paditësi/paditësit kundër të paditurit/të paditurve. Sipas Neni 274, paragrafi 1 i LPK-së aktgjykimi duhet gjithashtu t'i aplikohet *palës së tretë*, kjo e fundit është trajtuar si *palë ndërgjyqëse e përbashkët e palës kryesore* ajo është bashkuar për të mbështetur sipas Neni 271, paragrafi 1 i LPK-së. Shuma, *res judicata* aplikohet vetëm ndërmjet palëve duke pasur një status procedural të kundërt, duke qenë jo i aplikueshëm ndërmjet atyre që qëndrojnë në anën e njëjtë të procedurës. *Per argumentum ad contrario* nga Neni 167, paragrafi 1 i LPK-së të gjithë *personat e tretë* të cilat nuk kanë fituar statusin procedural të palës në lëndë nuk janë të lidhura nga *res judicata* të aktgjykimit të formës së prerë të nxjerrë në atë dhe

nuk janë të adresuarit të saj. Së këndejmi, secili person i tillë i tretë mbetet me të drejtë të parashtrorj padi të re për të drejtën tashmë të aprovuar apo të refuzuar me *res judicata* ndërmjet palëve në rastin e përfunduar. Në lidhje me një person të tillë të tretë *res judicata* bile as nuk vepron si supozim i arsyeshem për pajtueshmërinë e gjendjes ligjore reale me atë të përcaktuar në seancë të mbajtur pa pjesëmarrje të tij/saj.

22. *Res judicata* nuk duhet të barazohet në *ndikimin legjitimes* të aktgjykimit të formës së prerë. E fundit bazuar në trustin publik në të, pas gabimit në fakte apo ligj mund të prodhoj trillim, i dëmshëm tek titullari aktual i të drejtës së kontestueshme. Po që se ai i mëhershmi nuk ka intervenuar në seancë për këtë të drejtë të mbajtur në *mungesë të tij/saj*, ai apo ajo munden akoma të mbrohen kundër ndikimit legjitim të këtij vendimi përfundimtar duke parashtruar çdo lloj të padisë (identike, të ngjashme apo në tërësi ndryshe) në procedurë të re kontestimore.

23. *Res judicata* ka prodhuar me çdo vendim përfundimtar të juridiksionit kompetent duhet të dallohet gjithashtu nga *ndikimi i tij dëshmuar*. Përderisa arsyetimi përmban fakte, të vërtetuara si të dëshmuara apo të mohuara, këto konstatime janë vetëm prova të *rrethanave* për faktet përkatëse. Edhe pse gjenden në dokument publik, ata gjithmonë munden të ankimohen për *pasaktësi* sipas Nenit 329, paragrafi 3 i LPK-së, nuk kanë vlerë testuese obligative dhe kolegji në procedurë vijuese mundet lehtas të vlerësoj ata si çdo provë tjetër. Apo, përderisa *res judicata* është e vlefshme vetëm për të drejtën e kontestuar ndërmjet palëve, që në mënyrë që nuk munden të përmbushen, dhe duhet të respektohet, *ndikimi i provave të vendimit* për faktet në arsyetim të tij munden të kundërshtohen palëve të treta dhe rastësisht të kundërshtoj në seancë tjetër.

24. Siç u paraqit, *res judicata* pengon vazhdimin e kontestit nga institucioni i procedurës së re gjyqësore në atë sipas Nenit 166, paragrafi 2 dhe Neni 391, pika d) e LPK ku në mënyrë imperative e obligon gjykatë të hedh poshtë *ex officio* ndonjë padi që e përsërit atë tashmë të gjykuar në formë përfundimtare. Sidoqoftë, një hedhje poshtë e tillë duhet të vendoset pas krahasimit të vetëdijshëm dhe të kujdesshëm të rastit të përfunduar dhe në pritje dhe është gjetur *identitetin i plotë i palëve dhe çështjes lëndore* të dy seteve të procedurës. Në vend të parë, ajo e kontestueshme e sjellë para gjykatës duhet të jetë e njëjtë në çdo aspekt me atë të vendosur. E drejta – e cila i nënshtrohet *res judicata* në rastin e përfunduar duhet të mbivendos të drejtën – që i nënshtrohet rastit të ri në karakteristikat thelbësore të individualizimit të tij. Kjo do të thotë të dy identitetet të deklaratës së padisë dhe identitetin në gjendjen faktike. Ky

dyfishim mandator sipas Nenit 166, paragrafi 2 lexo në lidhje me Nenin 160, paragrafi 3, Neni 166, paragrafi 1 dhe Neni 167, paragrafi 2 i LPK-së përjashtohet nëse ka dallim në bazë të padisë me *res judicata* dhe ai nën gjykim në rastin e ri, *petitumi* dhe/apo materiali i *periudhës kohore*. Në vend të dytë, për *res judicata* të jetë pengesë procedurale për seancë të re, është e nevojshme gjithashtu *identiteti subjektiv* i dy seteve të procedurave – palët ndërgjyqëse në rastin e dytë duhet të jenë të adresuara në *res judicata* në rastin e parë. Nuk është e nevojshme për të gjithë personat – palët në procedurë të mbaruar të jenë palë në ato të themeluara të reja – pjesëmarrja e disa prej tyre mjafton. Në anën tjetër, përfshirja në seancë të re të personit – jo të adresuar të *res judicata* nuk e asgjëson atë për ish palët ndërgjyqëse të lidhura nga ajo. Identiteti subjektiv mundet të jetë vetëm i *pjesërishëm* dhe jo i plotë për *res judicata* për të aplikuar. Vetëm ku një dublikatë e tillë sa i përket *palëve si dhe çështjes lëndore* është konstatuar ndërmjet procedurës aktuale dhe të mëhershme, padia e re është *res judicata*. Në të kundërtën, pa një dublikatë të tillë objektive dhe subjektive, dy setet e procedurës nuk mund të jenë në harmoni, vendimet në ato nuk mund të jenë në konflikt – veç kësaj, *res judicata* nuk mund të bllokoi si pengesë procedurale seancën e re, ndërsa padia në të duke qenë e pa vendosur është e lejueshme dhe si e tillë bie jashtë Nenit 166, paragrafi 2 dhe Neni 391, pika d) e LPK-së. Nuk jep ngritje në përsëritje të paraparë në këto dy dispozita si identitet i palëve, identitet të deklaratës së padisë dhe identitet të gjendjes faktike. Nëse ka ndonjë dallim të ndonjërës nga këto elemente, *res judicata* e aktgjykimit të formës së prerë në rastin e parë nuk ka mundur të shkelet dhe kështu që nuk mbrohet me anulimin e rastit të dytë. Pandryshueshmëria që paraqitet nga parimi i sigurisë ligjore mbetet i garantuar në parashkrim të *res judicata* të formuar, gjithashtu bazuar në ligj. Në pasojat e saj aktgjykimi i formës së prerë nuk është shumë i përkryer dhe besimit legjitim sipas *res judicata* të tij nuk duhet të keqpërdoret.

25. Kërkesa e ndikimit të *res judicata* të aktgjykimit të formës së prerë brenda parashkrimit të tij, objektiv, subjektiv dhe të përkohshëm, është burim i vet parimit të sigurisë ligjore. Mos aplikimi i saj jashtë këtyre kufijve nuk përbën nisje nga ajo e arsyetuar me rrethanat e karakterit thelbësor dhe/apo obligativ (*Ryabykh v. Russia*, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX, *Salov v. Ukraine*, nr.65518/01, § 93, ECHR 2005-VIII; *Protsenko v. Russia*, nr.13151/04, § 26, 31 gusht 2008). Parimi i sigurisë ligjore nuk është kështu i lënë mënjanë por i respektuar në procedurë, edhe pse i ndërlidhur, nuk janë përsëritës në kushtet objektive apo subjektive, ndërsa interesat e të gjitha palëve të përfshira janë të ngujuara në balancë të drejtë me nevojën e sigurimit të

administrimit të drejtësisë (*Nikitin v. Russia*, nr. 50178/99, § 59, ECHR 2004-VIII, dhe *Kulkov dhe Tjerët*, § 27).

Aktgjykimi C.nr.100/06 i Gjykatës Komunale në Suharekë, i datës 19 maj 2006 vis-à-vis C.nr.28/11 i Gjykatës Komunale të Suharekës

26. Duke u kthyer në rrethanat e rastit aktual në padinë C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale në Suharekë nuk i bën dublikatë atë të gjykuar në aktgjykimin e formës së prerë, C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006 siç është kërkuar nga Neni 166, paragrafi 2 i LPK-së.

Mungesa e identitetit objektiv sipas Nenit 166, paragrafi 2 i LPK

27. C.nr.100/06 në Gjykatën Komunale të Suharekës ishte iniciuar nga padia e parashtruar më 13 prill 2006 nga GA nga Suhareka si paditës kundër KOMUNËS të Suharekës si e paditur. Faktet e pretenduara në të ishin që në vitin 1984, GA iu ishte ndarë një apartament dy dhomash në ndërtesën e postës së vjetër në Suharekë në katin e II, nr. 5, me sipërfaqe prej 41.16 m² sipas kërkesës së tij Nr. 1493, të datës 6 nëntor 1984 në Komisionin për Ndarje të Apartamenteve në Sekretariatit e Punëve të Brendshme–Suharekë, me vendim të pa nënshkruar me dorë në të që “*apartamenti iu ishte ndarë më 23.11.1984*”. Mungesa e Vendimit përkatës për ndarje të këtij apartamenti përderisa ishte pranuar nga GA në padi ishte arsyetuar me humbje të tij dhe mos disponueshmëri në arkiv të Stacionit Policor në Suharekë, i mbajtur për dokumentim pas vitit 1999 sipas Letrës së tij, të datës 28 mars 2006. Gjithashtu e pretenduar në padi ishte shfrytëzimi i apartamentit nga GA pas vitit 1984 në pajtim me Verifikimin Nr. 66 të lëshuar nga Ndërmarrja Komunale e Komunalisë–Suharekë më 2 prill 2001, Lista nr. 135 e shfrytëzuesve të apartamenteve me pronësi shoqërore në Komunën e Suharekës, të datës 17 prill 1990 me emrin e tij që duket nën nr. 85, dëftesa e pagesës Nr. 342/12, të datës 29 tetor 1985 për qira të paguar nga GA për muajt II – X 1985, dhe Konkluzioni 03 Nr. 360-380 i Departamentit të Urbanizmit, Komunale-Rezidencialë dhe Çështje Banesore në Suharekë, të datës 4 prill 1995 duke lejuar ekzekutimin duke zbrazur nga njerëzit dhe gjësendet apartamentin me pronësi shoqërore Nr. 5 në Suharekë, Rr. “Car Dušan” nr.59, të bëhet kundër GA më 12 prill 1995. *Deklarata e padisë* ishte që gjykata të konfirmoj që GA prej vitit 1984 ka qenë shfrytëzues i përhershëm i apartamentit në ndërtesë të postës së vjetër në Suharekë, kati II, nr. 5 me sipërfaqe prej 41.16 m² dhe të obligoj KOMUNËN e Suharekës si e paditur të njeh këtë të drejtë të shfrytëzimit të përhershëm.

28. C.nr.100/06 e Gjykatës Komunale të Suharekës ishte gjykuar në seancë kryesore më 19 maj 2006 pa ndonjë precizim, modifikim dhe/apo ndryshim të padisë. Dokumentet e bashkëlidhura në të janë administruar në procedurë testuese pa fakte tjera të reja apo prova të paraqitura nga palët në procedurë.

29. Me aktgjykimin C.nr.100/2006 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006 ishte verifikuar që GA prej vitit 1984 është shfrytëzues i përhershëm i apartamentit dy dhomash në ndërtesë të postës së vjetër në Suharekë, Rr. “Dëshmorët e kombit”, kati i II, nr.5, me sipërfaqe prej 41.16 m² (*ffalia e parë e dispozitivit*). Komuna e Suharekës si e paditur ishte e obliguar të njeh këtë të drejtë si shfrytëzim të përhershëm paditësit GA (*ffalia e dytë e dispozitivit*). Në *arsyetim* bazuar në Verifikimin Nr. 66 të Ndërmarrjes Komunale të Komunalisë – Suharekë, të datës 2 prill 2001 dhe Lista Nr. 135 të shfrytëzuesve të apartamenteve me pronësi shoqërore në territor të Komunës së Suharekës, të datës 17 prill 1990 ishte vërtetuar që GA ka qenë duke përdorur apartamentin prej vitit 1984 pa pengesë nga ndokush. Duke cituar Nenin 11 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 11/83, 29/86 dhe 42/86) (“LMB”) që *qytetarët fitojnë të drejtën e banimit në ditën e shpërnguljes së ligjshme në apartament*, Komuna e Suharekës e ka gjetur në vitin 1984 vendosjen e GA në apartamentin e sipërpërmendur me pronësi shoqërore si të mjaftueshëm për fitim të së drejtës në shfrytëzim të apartamentit në mënyrë të përhershme.

30. Duke u bërë i pa ankimuar më 26 qershor 2006 dhe kështu i formës së prerë sipas Nenit 333, paragrafi 1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr. 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 20/90, 27/90, 35/91 dhe Gazetës Zyrtare të RSS Nr.27/92, 31/93, 24/94, 12/98) (“LPK 1977”), aktgjykimi C.nr.100/06 i Gjykatës Komunale në Suharekë, i datës 19 maj 2006 formoi *res judicata* të saj vetëm mbi këtë padi kryesore të vendosur nga ajo sipas Nenit 187, paragrafi 1 i LPK-së 1977 me vërtetim të së drejtës në shfrytëzim të përhershëm të GA në apartamentin dy dhomash i cili gjendet në ndërtesën e postës së vjetër në Suharekë, Rr. “Dëshmorët e kombit”, kati i II, nr.5, me sipërfaqe prej 41.16 m² sipas *Nenit 11 LMB bazuar në posedimin e tij prej vitit 1984 të kësaj prone shoqërore*.

31. Jo në mënyrë të njëjtë, në padinë në C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale në Suharekë, si është detajuar në paragrafin 1 më lart, përmban pretendimet e JC i të qenit “*bartës i të drejtës së banimit, që do të thotë të drejtën e posedimit të apartamentit në Suharekë, Rr. “Car Dušan, Hyrja I, kati II, nr.5, me një sipërfaqe prej 41 m²”* e dëshmuar me Vendimin HPCC/D/233/2005/C, të datës 16 dhjetor 2005 dhe

Vendimin HPCC/REC/76/2006, të datës 18 tetor 2006. Ndërtesa me apartamentin e përmendur ishte demoluar në vitin 2010 dhe një i ri ishte ndërtuar në ngastrën e njëjtë nga “BA” Sh.P.K. bazuar në Marrëveshjen me Komunën e Suharekës. JC e konsideron vetëm me të drejtë “*të drejtën në apartamentet në ndërtesën e re bazuar në të drejtën në apartament në atë të shkatërruar.*” “BA” SH.P.K. dhe Komuna e Suharekës, të paditurit e parë dhe të dytë në rast, sidoqoftë, kanë refuzuar të njohin të drejtën e tij: në vend të trajtimit të GA, të paditurit të tretë, si bartës i kësaj të drejte, edhe pse ai në mënyrë të paligjshme ka shfrytëzuar apartamentin dhe ka dështuar të legjitimoj vetën në procedurë të HPD/HPCC. Çdo referim eventual nga të paditurit në këtë çështje në vendim të ndonjë autoriteti tjetër është kundërshtuar nga padia si e pabazë pasi që JC bazuar në të drejtën e tij në Vendimet e HPCC i cili duke qenë detyrues dhe i zbatueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 nuk duhet t’i nënshtrohet verifikimit nga ndonjë autoritet tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë. Kërkesa në gjykatë në *deklaratën e kësaj padie* për të obliguar të paditurit e parë dhe të dytë t’i ofrojnë paditësit apartamentin në ndërtesën e re në Suharekë, Rr. “Car Dušan” nr.59, me sipërfaqe prej 41 m², apo të kompensoj atë me një shumë të barabartë me vlerën e tregut, si dhe të urdhëroj këtë të paditur të tretë të pres përmbushjen e këtyre obligimeve.

32. Ky ballafaqim tregon *jo identitetin objektiv* të C.nr. 100/06 dhe C.nr. 28/11 të Gjykatës Komonale të Suharekës. Kontestet në këto dy lëndë civile janë të ndryshme. Pyetja e paraqitur në C.nr. 28/11 – *nëse ka të drejtë në kompensim të apartamentit në ndërtesë të ndërtuar të re bazuar në posedimin e apartamentit në ndërtesën e shkatërruar në periudhën gusht 1995 – mars 1999* nuk e përsërit pyetjen e zgjidhur me *res judicata* në C.nr.100/06 që GA ka shfrytëzuar apartamentin në ndërtesë të vjetër në periudhën nëntor 1984 – prill 1995. Dublikati në çështjen lëndore qartë e paraqitur nga Neni 166, paragrafi 2 i LPK-së si parakusht për palejueshmërinë e *res judicata* sipas Nenit 391, pika d) e LPK-së mungon në C.nr. 100/06 kundër C.nr. 28/11; kjo nga vet përjashton aplikimin e këtyre dispozitave dhe e bën ligjërisht të pabazuar hedhjen poshtë *res judicata* të padisë në rastin e dytë. Është një qëndrim i pa kundërshtueshëm i ri konfirmuar në jurisprudencën e Kosovës që kundërshtimi *res judicata* është i bazuar nëse ka *identitet të palëve, identitet të deklaratës së padisë, dhe identitet të bazës faktike*. Dallimi në ndonjërin nga këto aspekte i dy seteve të procedurës – i finalizuar vs. të sapo themeluar – e bën kundërshtimin *res judicata* të pabazuar. C.nr.100/06 dhe C.nr.28/11 janë në divergjencë në lidhje me të gjitha këto elemente.

33. Gjendja e ndryshme faktike. Nuk ka identitet objektiv të dy rasteve të ballafaquara në vend të parë për mungesë të *ngjashmërisë në bazën faktike* të padive – çështjes së tyre lëndore. Vendimtar është dallimi në gjendjen faktike në këto procedura si ngjarje të jetës, në mënyrë objektive kanë ndodhur në të kaluarën, pa marrë parasysh kualifikimin e tyre juridik. *Së pari*, në C.nr.100/06 faktet e pretenduara në padi dhe të vërtetuar nga nxjerrja e aktgjykimit nga Gjykata Komunale e Suharekës ishin që më datën 23 nëntor 1984 GA iu ishte ndarë apartamenti në ndërtesën e vjetër të postës në Suharekë në katin e II, nr. 5, me sipërfaqe prej 41.16 m² nga Sekretariati i Punëve të Brendshme – Suharekë sipas parashtrësës së tij Nr. 1493, të datës 6 nëntor 1984; ky shfrytëzim ka vazhduar në vite pas dëshmimit nga Lista Nr.135 të shfrytëzuesve të apartamenteve me pronësi shoqërore në Komunën e Suharekës, të datës 17 prill 1990, Konkluzioni 03 Nr. 360 – 380 të Departamentit të Urbanizmit Komunal dhe Çështjeve Banësore – Suharekë, të datës 4 prill 1995 duke lejuar dëbimin e GA më 12 prill 1995, pas ndërprerjeve të paidentifikuara në kohëzgjatjen e tyre, ai përsëri ishte duke e shfrytëzuar këtë apartament, në atë kohë C.nr. 100/06 ishte gjykuar. *Së dyti*, në C.nr. 28/11 faktet e rëndësisë së pretenduar në padi janë posedimi i ushtruar nga JC në apartamentin nga gushti 1995 deri në mars 1999; humbja e këtij posedimi në konfliktin e vitit 1999 dhe rivendosja e tij në atë në vitin 2007 bazuar në Vendimin e Nr. HPCC/D/233/2005/C, dhe Vendimin Nr. HPCC/REC/76/2006; demolimi i ndërtesës në vitin 2010; ndërtimi i ndërtesës së re në ngastër të njëjtë. Paralelja manifeston qartë mos identifikimin e fakteve të vërtetuara nga aktgjykimi C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006 sipas Nenit 160, paragrafi 4 dhe Nenit 166, paragrafi 1 i LPK *vis-à-vis* faktet – bazën e deklaratës së padisë së parashtruar në C.nr.28/11 sipas Nenit 253, paragrafi 1, pika b) e LPK-së.

34. *Petition i Ndryshëm.* Gjithashtu nuk ka *ngjashmëri në petition të dy padive*, përkundrazi në kërkesën e publikatit të Nenit 166, paragrafi 1 i LPK. *Së pari*, në C.nr. 100/06 kërkesa e pretenduar nga paditësi dhe aprovuar nga dispozitivi i aktgjykimit sipas Nenit 160, paragrafi 3 i LPK ishte për të vërtetuar që GA prej vitit 1984 ka qenë *shfrytëzues i përhershëm* i apartamentit dy dhomash në ndërtesën e postës së vjetër në Suharekë, kati i II, Nr. 5 me sipërfaqe prej 41.16 m². *Së dyti*, në C.nr.28/11 deklarata e padisë së JC sipas Nenit 253, paragrafi 1, pika a) e LPK përmban dy pretendime alternative për *kompensim real në apartament* në ndërtesë në Suharekë, Rr. “Car Dušan” nr.59, ndërtim i ri pas demolimit të ndërtesës së vjetër në këtë adresë në vitin 2010, apo *kompensim monetar në shumë të barabartë me vlerën e tregut*. Më sa duket, *petitioni* i parë gjykata për të vërtetuar të drejtën në shfrytëzim mbi apartamentin në

ndertësë të vjetër duke lëshuar aktgjykim deklarativ sipas Nenit 252, hipoteza e dytë dhe Nenit 254, paragrafi 1 i LPK-së në lëndën e gjykuar (C.nr.100/06) *nuk është i barabartë me petitumin* e dytë gjykata për të zbatuar kryerjen e obligimeve të pa përmbushura për kompensim me banesën në ndërtesën e re apo vlerës së tij të tregut sipas Nenit 252, hipoteza e parë e LPK-së në rastin e caktuar më vonë (C.nr. 28/11). Krahasimi paraqet *jo identitet të deklaratave të padive* të marra në Gjykatën Komunale në Suharekë në dy sete të procedurës. Të ndryshme janë të drejtat materiale në çështjen gjyqësore dhe kërkesën e mbrojtjes juridike me qëllim të mbrojtjes së atyre – në C.nr.100/06 – vetëm *res judicata* e aktgjykimit deklarativ për vërtetim të së drejtës në shfrytëzim të apartamentit me pronësi shoqërore; në C.nr. 28/11 - *res judicata* dhe *fuqi ekzekutive* të aktgjykimit për zbatim të obligimeve alternative të pa përmbushura për kompensim real monetar. Pas një mospërputhje të tillë ndërmjet deklaratave të dy padive, kërkesa për ngjashmëri të tyre sipas Nenit 166, paragrafi 2 i LPK-së nuk është plotësuar – si *petitum* padia e vendosur në C.nr.100/06 nuk është e ngjashme me padinë me vonë të paraqitur për gjykim në C.nr.28/11.

35. Kufijtë e përkohshëm të ndryshëm. Siç është paraqitur, *res judicata* nuk është valide në mënyrë të pacaktuar të kohës – ajo përcakton ekzistimin/mos ekzistimin e të drejtës së gjykueshme bazuar në faktet e thirrura dhe të dëshmuara në procedurë prej datës së mbarimit të seancës kryesore pas së cilës aktgjykimi është marrë dhe është bërë i formës së prerë – Neni 167, paragrafi 2 i LPK-së. Duke pasur këta kufij të përkohshëm të saj *res judicata*, aktgjykimi C.nr.100/2006 i Gjykatës Komunale të Suharekës, i datës 19 maj 2006 i ka njohur GA si *shfrytëzues i apartamentit* në ndertësë të postës së vjetër në Suharekë, Rr. “Car Dušan”, Kati II, nr.5, i cili është bartur në të më 23 nëntor 1984 dhe ka jetuar në atë më 19 maj 2006, data e mbarimit të seancës kryesore në C.nr. 100/06. *Duke u bërë e pamundur nga res judicata* të këtij aktgjykimi janë faktet bazuar në të cilat Komuna e Suharekës si e vetmja e paditur në C.nr.100/06 ka mundur të kundërshtoj shfrytëzimin e cekur më lart të apartamentit nga GA. Përkundrazi, *mos pengimi* nga kjo *res judicata* mbeten: a) të gjitha faktet e ndodhura *deri më 19 maj 2006* që çdo person i tretë ka mundur të kundërshtoj kundër padisë së GA në C.nr.100/06, për shembull shfrytëzimi i apartamentit në ndërtesën e vjetër nga JC në periudhën gusht 1995 – mars 1999; dhe b) të gjitha faktet pas 19 majit 2006, për shembull finalizimi i procedurës në HPD/HPCC në lidhje me pronën e njëjtë rezidenciale me hyrjen në fuqi më 18 tetor 2006 të Vendimit Nr. HPCC/D/233/2005/C dhe Nr. HPCC/REC/76/2006 të HPCC; Dëbimi i HPD (HABITATIT) më 20 shkurt 2007; përfundimi i marrëveshjes mbi Shfrytëzimin e Tokës Ndërtimore në Pronësi Shoqërore ndërmjet Komunës së Suharekës dhe “BA”

Sh.P.K. më 27 gusht 2008; shkatërimi i ndërtesës së vjetër në vitin 2010, ndërtimi i ndërtesës së re në ngastrën e njëjtë pas disa viteve, dhe ndarja e objekteve në këtë ndertësë të re pronarëve dhe e drejta në shfrytëzim zotëruesve të lokaleve në atë të demoluarën. *Res judicata* sipas Nenit 167, paragrafi 2 i LPK-së përcakton statusin e raportit juridik në çështjen gjyqësore në kohën e mbarimit të seancës kryesore por nuk e pengon atë në zhvillimin e ndodhisë së saj. Raporti juridik nuk është i ngurosur në gjendjen e tij në momentin që aktgjykimi është bërë i formës së prerë. Pastaj, mund të ndryshohet në çdo kohë në çdo mënyrë si rezultat i paraqitjes së fakteve të reja pas formës së prerë të aktgjykimit. Duke pasuar në mënyrë kronologjike formimin e *res judicata*, të gjitha ndryshimet e tilla nuk bien në fushëveprimin e tij. Nëse ngritët kontesti, mund t'i paraqitet kolegjit nga padia që nuk mund të jetë e palejueshme për *res judicata* me të cilën para këtyre fakteve të reja më vonë, e ndryshuar nga ato, është përcaktuar. Publikati i paraparë në Nenin 166, paragrafi 2 i LPK-së është i përjashtuar si padi e re është për një *periudhë tjetër të suksesshme të së drejtës, jo për një periudhë vijuese* për të cilën *res judicata* është e vlefshme. Kjo kohë automatikisht parapërGAit dallimin në çështjen lëndore të C.nr. 100/06 *vis-à-vis* C.nr.28/11, dhe në çështjen lëndore të *res judicata* e formuar nga aktgjykimi i formës së prerë në rast të parë *vis-à-vis* ajo e kërkuar për lëshim të rastit të dytë. E nxjerrë më 19 maj 2006, aktgjykimi në C.nr. 100/06 është pa efekt ligjor *për të gjitha faktet pas kësaj date* lidhur me shfrytëzimin dhe posedimin e apartamentit në Suharekë, Rr. “Car Dušan”, kati i II, nr.5. *Res judicata* është formuar më 26 qershor 2006, kur aktgjykimi C.nr. 100/06 të Gjykatës Komunale në Suharekë, të datës 19 maj 2006 është bërë i pa ankimuar dhe i formës së prerë, është *jo pengues* për të gjitha faktet e datës së dorëzimit – bazë e padisë në C.nr.28/11 që ka ndodhur në periudhën kohore prej 18 tetorit 2006 (data e fillimit të C.nr.28/11). Të gjithë nga ata përcjellin në mënyrë kronologjike përfundimin e seancës kryesore në C.nr.100/06 më 19 maj 2006, lëshimi i aktgjykimit në rast të njëjtë më 19 maj 2006 dhe hyrjen e saj në fuqi më 26 qershor 2006. *Res judicata* e aktgjykimit C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale në Suharekë, të datës 19 maj 2006 nuk shpërndalet mbi listën e fakteve më lart pas formimit të saj më 26 qershor 2006. *Kufijtë e përkohshëm të res judicata* të aktgjykimit C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006 të kufizuar deri më 26 qershor 2006 nuk koïncidon me *kufijtë e përkohshëm të padisë në C.nr. 28/11* i shpërndarë jashtë datës 26 qershor 2006. Rastet janë në papajtueshmëri *ratione temporis*. Ky dallim kohor rezulton në dallimin në çështjen lëndore të dy rasteve, duke përjashtuar identitetin e tyre objektiv dhe duke e bërë të ankimueshme *res judicata* hedhjen poshtë të palejueshme.

36. Duke përfunduar, sipas kushteve objektive çështja e sjellë për gjykim në C.nr. 28/11 nuk e përsërit çështjen tashmë të zgjidhur me *res judicata* në C.nr. 100/06 – nuk ka as identitet të bazës faktike të padive në dy rastet, e as identitet të deklaratave të këtyre padive në kundërshtim me Nenin 166, paragrafi 2 i LPK. E drejta në shfrytëzim të përhershëm të GA mbi apartamentin me pronësi shoqërore në ndërtesë të vjetër e njohur me *res judicata* në C.nr.100/06 sa i përket posedimit të saj prej datës 23 nëntor 1984 dhe 19 maj 2006 nuk e mbulon të drejtën për kompensim të JC me apartament në ndërtesë të re apo vlerën e saj të pretenduar në treg në C.nr.28/11 sa i përket posedimit të tij mbi apartamentin e tij të dorëzuar nga dëbimi i HPD më 20 shkurt 2007 në ekzekutim të Vendimit të HPCC Nr. HPCC/D/233/2005/C. Këto dy të drejta materiale – e para tashmë e vendosur me *res judicata* dhe e dyta më vonë e vendosur për gjykim – janë të dallueshme nga njëra tjetra në të gjitha tiparet e tyre individualizuese – baza, përmbajtja, titullari, kualifikimi ligjor dhe afati kohor i ekzistimit. Duke pasur mospërputhje të tilla, çështja lëndore e *res judicata* në C.nr.100/2006 nuk është e ngjashme si çështja lëndore e padisë në C.nr.28/2011. Pas një jo identiteti të tillë objektiv, Neni 166, paragrafi 2 i LPK-së nuk është i aplikueshëm – procedura e re në C.nr.28/2011 nuk ka mundur të konsiderohet e iniciuar bazuar në padinë që tashmë është përcaktuar nga aktgjykimi i formës së prerë në C.nr.100/2006.

Mungesa e identitetit subjektiv sipas Nenit 167, paragrafi 1 i LPK

37. Identiteti subjektiv ekziston po që se *palët* në procedurë të re të krijuar janë të adresuarit të *res judicata* të aktgjyqimit të formës së prerë në procedurë tashmë të përfunduar sipas Nenit 167, paragrafi 1 i LPK-së.

38. Padi në C.nr.100/06 e Gjykatës Komunale të Suharekës ishte parashtruar nga AGA si *paditës kundër KOMUNES* së Suharekës si e *paditur*. Nuk ka dy kuptimësi në individualizimin e tyre dhe/apo statusin procedural të treguar në këtë padi. Me parashtrësën e vet më 13 prill 2006 në formë të shkruar nga përshkrimi i vlefshmërisë së tij nga Neni 106, paragrafi 1 i LPK-së 1977, GA dhe KOMUNA e Suharekës bëhen *ex lege* palë ndërgjyqëse në procedurë Kontestimore të iniciuar nga ai sipas Nenit 185 të LPK-së 1977. Padia nuk ishte *korrigjuar apo plotësuar* – Neni 109 i LPK 1977. Fushëveprimi i saj subjektiv nuk ishte ndryshuar në procedurë në ndonjë bazë. As GA, as KOMUNA e Suharekës nuk ishte *zëvendësuar* në rolet e tyre procedurale; ato nuk ishin të *bashkuara* nga paditës të ri apo të paditur të ri në proces gjyqësor të përbashkët sipas Neneve 196 – 197 LPK-së 1977. Nuk ka pasur ndonjë *interferencë kryesore* nga ndonjë person që pretendon të drejtat mbi apartamentin sipas Nenit 198 të LPK-së 1977. Asnjë *palë e tretë* që ka marrë pjesë në procedurë pas *intervenimit* në

iniciativë të tij – Neni 206 i LPK-së 1977, apo pas *shkatërrimit* nga paditësi *apo i padituri* – Neni 211 i LPK-së 1977. Kështu, fushëveprimi subjektiv i procesit gjyqësor mbetet si fillimisht i definuar nga padia – kontesti ishte gjykuar sa i përket GA si *paditës* i vetëm dhe KOMUNA E Suharekës si *e paditur* e vetme. JC nuk ishte *de jure* e përbërë si një palë; JC nuk ka marrë pjesë *de facto* në seancë; JC nuk ishte paraparë në ndonjë cilësim në pjesën hyrëse, dispozitivi apo arsyetimi i aktgjykimit C.nr.100/2006 e Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006.

39. *Res judicata* nuk është në mënyrë universale e vlefshme brenda kufijve të saj të përcaktuar subjektiv. *Rregulla* caktohet sipas Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e parë e LPK-së – aktgjykimi i formës së prerë do të prodhoj efektin juridik *vetëm* ndërmjet *palëve ndërgjyqëse*. Ka dy *përjashtime* të paraqitura qartë të kësaj rregulle – aktgjykimi i formës së prerë prodhon efektin e tij juridik kundër *personave të tretë* për shkak të *natyrës së raportit të kontestueshëm juridik* – Neni 167, paragrafi 1, hipoteza e dytë e LPK-së apo *i nënshtrohet dispozitës të ligjit* – Neni 167, paragrafi 1, hipoteza e parë e LPK-së. Duke u kthyer prapa në C.nr. 100/06, si fushëveprim subjektiv i padisë ishte në pajtim dhe jo i tejkaluar, aktgjykimi i nxjerrë në lëndë bëhet i pa ankimeshëm dhe i formës së prerë më 26 qershor 2006 duke hyrë në fuqi në lidhje GAN si paditës dhe KOMUNA e Suharekës si e paditur. *Res judicata* e saj ishte *vetëm* ndërmjet *këtyre dy palëve ndërgjyqëse në lëndën e vendosur* sipas Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e parë e LPK-së; ato ishin të lidhura me këtë *res judicata* si të *adresuarit e vetëm* të saj. Të kufizuar në efektin e tij ligjor te GA dhe KOMUNA e Suharekës si palë në kontest të zgjidhur, aktgjykimi C.nr.100/2006 të Gjykatës Komunale të Suharekës të datës 19 maj 2006 *nuk ka prodhuar efekt juridik kundër ndonjë personi të tretë*. E pa përfshirë në kufijtë subjektiv të *res judicata* të saj është JC në veçanti. *Së pari*, aktgjykimi C.nr.100/06 i Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006 nuk ka mundur të kundërshtohet nga JC sipas Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e parë e LPK-së përkundrazi sipas kësaj dispozite *ai nuk ishte palë* në rastin e vendosur. *Së dyti*, nuk ka ndonjë veçanti të natyrës të *raportit juridik në kontestit* duke zgjeruar *res judicata* të aktgjykimit C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006 të JC sipas Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e dytë e LPK-së. Një zgjerim i tillë nuk ka mundur të arsyetohet nga *trashëgimia ligjore* pasi që kjo nuk ka ndodhur në ndonjë formë gjatë procedurës ndërmjet ndonjë pale në C.nr.100/06 dhe JC. Në veçanti, apartamenti i kontestueshëm nuk ishte tjetërsuar nga ndonjë nga palët ndërgjyqëse gjatë kontestit në hipotezat e Nenit 195, paragrafi 1 i LPK-së 1977 – aktgjykimi C.nr. 100/06 i Gjykatës Komunale të Suharekës të datës 19 maj 2006 nuk ka mundur të ketë pasoja ligjore tek JC si fitues i këtij objekti të

gjykueshëm – Neni 195, paragrafi 2 i LPK-së 1977. *Res judicata* e zgjeruar nuk ka mundur të rrjedhë nga varësia e gjendjes së tij juridike të asaj të GA apo KOMUNES së Suharekës, pasi që ata nuk janë pjesëmarrës. Pasi që nuk kishte *shqyrtim të shqyrtuar të përbashkët gjyqësor* për të drejtën në shfrytëzim të apartamentit të kontestueshëm ndërmjet JC dhe ndonjë pale në C.nr.100/06, aktgjykimi nuk është i aplikueshëm tek JC sipas Nenit 201 të LPK-së 1977, pa marrë parasysh mos pjesëmarrjen e tij në procedurë të vendosur nga ajo. Kontesti në C.nr.100/06 nuk është mbi statusin civil dhe zgjidhja e saj nuk mund të jetë në bazë *erga omnes* për atë arsye. *Së treti*, asnjë dispozitë nuk aplikon efektin ligjor të aktgjykimit të formës së prerë mbi konstestin e së drejtës në shfrytëzim të personave të tretë, jo pjesëmarrësit në gjykim të saj. Duke përmbledhur, JC nuk është i detyruar nga *res judicata* e aktgjykimit C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006 – për *mungesë të statusit procedural të palës* sipas Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e parë e LPK-së, për *mungesë të veçantive në të drejtën e kontestueshme* sipas Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e parë e LPK-së, dhe për *mungesë të zgjerimit të dispozitës efektin e këtij aktgjykimi tek personat e tretë* sipas Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e tretë e LPK-së. Pasi që ky aktgjykim nuk aplikohet tek JC, pa qenë i adresuar në *res judicata* të tij, ai mbeti me të drejtë procedurale të parashtrij ndonjë padi në lidhje me apartamentin e shkatërruar apo ekuivalenten e tij kundër çdo personi, përfshirë palët në C.nr.100/2006 të Gjykatës Komunale të Suharekës. Procedura e re e kontestueshme e krijuar në C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës nga JC nuk është e palejueshme për *res judicata* si C.nr.100/2006 të Gjykatës Komunale të Suharekës ishte më herët e gjykuar ndërmjet GA dhe KOMUNES së Suharekës dhe *anasjelltasi* nuk ishte gjykuar sa i përket JC.

40. Identiteti subjektiv i paraparë nga Neni 166, paragrafi 2 i LPK-së këtu nuk ekziston si *palë ndërgjyqëse – palës me status të kundër procedural* nuk janë një dhe të njëjta në C.nr.100/06, duke pasur GA vs. KOMUNES së Suharekës, *vis-à-vis* C.nr.28/11, duke pasur JC vs. GA, “BA” Sh.P.K. dhe KOMUNEN e Suharekës. Për shkak të kësaj jo coincidence, *res judicata* në lëndën e parë të vendosur formuar nga GA vs. KOMUNES së Suharekës pasi që të adresuarit e saj nuk kanë mundur të rivendosen nga *res judicata* të aktgjykimit të ardhshëm në lëndën e dytë të pa vendosur si kur është nxjerrë dhe i formës së prerë, ai do të bëhej obligativ për JC vs. GA, “BA” Sh.P.K. dhe KOMUNEN e Suharekës. Kjo është arsyeja pse identiteti subjektiv për Nenin 391, pika d) në lidhje me Nenin 167, paragrafi 1 i LPK-së për tu aplikuar nuk ka mundur të arsyetohet me pjesëmarrjen e GA dhe KOMUNES së Suharekës në dy sete të procedurës – *res judicata* në C.nr.100/06 aplikohet ndërmjet

atyre për shkak të kapaciteteve të tyre *kundërshtuese të paditësit dhe të paditurit* përkatësisht. Sidoqoftë, *asnjë res judicata* nuk do të prodhohet *ndërmjet* atyre në C.nr.28/11 ku ata janë të caktuar si *të paditur* në procesin e përbashkët gjyqësor sipas Nenit 264 të LPK-së, duke pasur një të njëjtë të raportit juridik procedural pa *Lis Pendens* sipas Nenit 262, paragrafi 1 i LPK-së kundër njëri tjetrit. Një identitet i tillë subjektiv është në parim i përjashtuar nëse *paditësi dhe i padituri* në lëndën e vendosur janë *të dy të paditur* në lëndë të re – në këtë konfigurim *res judicata* e formuar në procedurë të parë nuk ka mundur të miratohet sërish dhe kështu e shkelur nga *res judicata* në pritje për shqyrtim në procedurë të dytë pasi që fushëveprimi i tyre *ad personam* i të adresuarve nuk mbulohet. Në fund, pasi që JC nuk ka marrë pjesë si palë në C.nr.100/06 në pajtim me Nenin 167, paragrafi 1 i LPK-së megjithatë aktgjykimi i formës së prerë C.nr. 100/06 i Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006 nuk ka prodhuar efekt juridik kundër atij si person i tretë. *Res judicata* e tij nuk mbulon JC në kushtet subjektive dhe duke qenë *de jure* i pa kundër-shtueshëm për atë nuk e bën padinë e tij të palejueshme në C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës sipas Nenit 166, paragrafi 2 i LPK-së.

41. Pas këtij ballafaqimi të C.nr.100/06 dhe C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës, gjykata e shkallës së dytë paraqet që *asnjë* nga kushtet kumulative të kërkuara për hedhjen poshtë *res judicata* nuk është plotësuar – *nuk ka identitet të deklaratës së padive, nuk ka identitet të bazave të tyre faktike dhe nuk ka identitet të palëve ndërgjyqëse* ndërmjet këtyre lëndëve. Në mungesë të kësaj ngjashmërie mandatore, gjykata e shkallës së parë ka shfrytëzuar Nenin 166, paragrafi 2 i LPK-së për të hedhur poshtë *padinë e parashtruar në C.nr. 28/11* edhe pse ajo nuk e dublikon *padinë e përcaktuar nga aktgjykimi i formës së prerë në C.nr.100/06* të Gjykatës Komunale të Suharekës. Ky aplikim i gabuar i Nenit 166, paragrafi 2 i LPK-së ka rezultuar në nxjerrjen e aktvendimit të hedhur poshtë të paligjshëm *res judicata* dhe përbën një shkelje thelbësore procedurale sipas Nenit 182, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 208 të LPK-së – një bazë ligjore sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) në lidhje me Nenin 208 të LPK-së për të lejuar ankesën sipas Nenit 209, paragrafi 1, pika d) e LPK-së.

Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore në DS 602221 vis-à-vis C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale në Suharekë

42. Hedhja poshtë *res judicata* me aktvendimin e ankimuar C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 30 maj 2012 nuk është i arsyetueshëm në mënyrë të

barabartë me vendimin e formës së prerë të HPCC-së nr. HPCC/D/233/2005/C dhe nr. HPCC/REC/76/2006.

43. Më 15 nëntor 1999, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/23 mbi Themelimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore (HPD) dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (HPCC) hyri në fuqi. Neni i saj 1.2 parasheh që një përjashtim i juridiksionit të gjykatave vendore, HPD pranon, regjistron dhe i referon në HPCC për zgjidhje të padive të paraqitura në dispozitë, *inter alia*: a) paditë e personave fizik pronësia e të cilëve, posedimi dhe e drejta e banimit në pronë të paluajtshme banesore nuk është revokuar së fundi deri në 23 mars 1989 në bazë të legjislacionit diskriminues në kërkesë të saj apo qëllim; c) paditë nga personat fizik të cilët kanë qenë pronarë, posedues apo zotërues të së drejtës së banimit në pronë të paluajtshme banesore para 24 marsit 1999, nuk e gëzojnë posedimin e vet, ku prona nuk është bartur në mënyrë vullnetare. Neni 2.5, fjalia e parë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 më tej paraqet që HPCC do të ketë juridiksion ekskluziv në vendosje të kategorive të padive të paraqitura në Nenin 1.2.

44. Më datën 8 korrik 2002, JC parashtroi Kërkesë DS602221 sipas Nenit 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 të HPD/HPCC me pretendimet faktike që ai ishte zotërues i të drejtës së banimit të apartamentit në Suharekë, Rr. “Car Dušan” Nr.59, kati i II, nr.5 bazuar në vendimin mbi ndarjen të lëshuar nga Sekretariati i Punëve të Brendshme – Suharekë në maj/qershor 1995 dhe kontrata në shfrytëzim të lidhur më vonë në vitin e njëjtë. Këto dokumente, sidoqoftë, nuk janë prezantuar nga JC duke mos qenë në dispozicion për të; në vend të kësaj ai paraqiti fletë pagesat për qira dhe shërbime komunale (telefon dhe ujë), të lëshuara në emër të tij në adresën e apartamentit të sipërpërmendur për të dëshmuar që familja e tij ka jetuar në të nga gushti 1995 deri në mars 1999, kur ata e kanë lëshuar Kosovën gjatë konfliktit dhe ishte uzurpuar nga personi i tretë. *Kërkesa në HPCC ishte për të kthyer posedimin e humbur të këtij apartamenti.*

45. Kërkesa DS602221 ishte aprovuar nga HPCC në shkallë të parë me Vendimin Nr. HPCC/D/233/2005/C, të datës 16 dhjetor 2005 të lëshuar sipas kushteve të Nenit 22.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 duke urdhëruar paditësin JC t’i jepet posedim i apartamentit, dhe duke e obliguar çdo person që është duke banuar në të të liroj atë brenda 30 ditëve nën kërcënim të dëbimit në rast të dështimit për të bërë. Ri-posedimi ishte vendosur bazuar në Nenin 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Nenit 2.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 – HPCC konstatoi që megjithatë JC nuk ka mundur të legjitimoj vetën si zotërues të së drejtës së banimit në

mungesë të vendimin të ndarjes dhe kontratës në shfrytëzim, dokumentet e ofruara nga ai për pagesë të qirasë dhe shërbimeve komunale kanë sugjeruar të drejtën e tij pronësore mbi apartamentin e kontestuar së paku në form të posedimit që nuk është manifestuar në mënyrë të paligjshëm. Në lidhje me këtë çështje HPCC ka aplikuar definicionin e veçantë për “të drejtë pronësore” në Nenin 1 të Rregullores së UNMIK -ut Nr. 2000/60 e paraqitur vetëm për qëllime të kësaj rregullore duke përfshirë pronësi, posedim të ligjshëm, të drejtën në shfrytëzim apo të drejtën e banimit. Në pajtim me këtë alternativë, e reflektuar qartë gjithashtu në Nenin 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23, Kërkesa Nr. DS602221 ishte miratuar nga HPCC si e qenë në mënyrë të rregullt e parashtuar nga JC as si pronar, e as si zotërues i të drejtës së banimit, por si posedues i apartamentit para 24 marsit 1999, duke mos gëzuar posedimin e tij më tutje. GA ka marrë pjesë në procedurë të HPCC-së si i paditur i cili e ka kundërshtuar kërkesën Nr. DS602221 si zotërues i të drejtës së banimit të apartamentit i cili ka jetuar në atë nga vitit 1985 deri në dëbim të tij në vitin 1990 dhe ka dorëzuar faturat e pagesës për qira dhe shërbime komunale. Me vendimin Nr. HPCC/D/233/2005/C, të datës 16 dhjetor 2005 (paragrafi 19) pas verifikimit në Ndërmarrjen Publike Banesore–Suharekë që GA kishte lëshuar apartamentin shumë më parë para datës 24 mars 1999, HPCC gjeti të gjitha kundërshtimet e tija dhe dokumentet të pavlefshme të mbrojtjes në kërkesën e paditësit Nr. DS602221.

46. Më datën 31 mars 2006, GA ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit të tij Nr. HPCC/D/233/2005/C, të datës 16 dhjetor 2005. Ai ishte refuzuar me Vendimin Nr. HPCC/REC/76/2006, të datës 18 tetor 2006 për mungesë të paraqitjes së provave të reja sipas Nenit 14.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 dhe nuk është gjetur ndonjë gabim material në kërkesë të kësaj rregullore sipas Nenit 14.1 (b) – paragrafi 5 i arsytimit. Kështu rishqyrtimi i procedurës ishte përfunduar siç ishte paraparë nga Neni 25 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Në mungesë të mjeteve juridike të mëtejme të parapara nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/60, Vendimet Nr. HPCC/D/ 233/2005/C, të datës 16 dhjetor 2005 dhe Nr. HPCC/REC/76/2006, të datës 18 tetor 2006 u bënë të formës së prerë. Ato ishin përmbaurar nga HPD përmes dëbimit të kryer më datën 20 shkurt 2007.

47. HPCC ishte themeluar sipas Nenit 2.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 si organ i pavarur i HPD-së për të zgjidhur kontestet private jo komerciale për pronën banesore të referuar në të nga HPD deri sa Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB përcakton që gjykatat vendore janë në gjendje të kryejnë këto funksione. HPCC duhet të jetë në dijeni si gjykatë në kuptim të Nenit 6

(1) të KEDNJ, duke pasur karakteristikat kryesore të përcaktuara në jurisprudencën e KEDNJ (*Bellios v Zvicër* A 132 (1988), 10 EHRR 466; *Qipro v Turqisë* 2001-IV, 35 EHRR 731; *H. v Belgjikë*, A 127-B (1987) 10 EHRR 339). Ajo ishte themeluar në bazë dhe në pajtim të ligjit të aplikueshëm në Kosovë. Iu ishin besuar funksionet gjyqësore, duke i marrë përkohësisht nga gjykatat vendore deri në bartje prapa pas fundit të mandatit të tij. HPCC i ka plotësuar kushtet për pavarësi – Neni 2.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23, Pjesa e paanshmërisë 17.12 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, koha zyrtare e anëtarëve – Neni 17.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, garanton duke i lejuar nga procedura e saj – Neni 18 dhe 19 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. HPCC kishte fuqinë statutores për të zgjidhur kontestet private në pronat banesore me vendim të detyrueshëm ligjor në bazë të rregullave të ligjit pas procedurës së kryer në mënyrë të përshkruar (*Bentham v Holandës* A 97 (1985) EHRR 1 PC). Kjo ishte një çështje ligjore thelbësore mbi kontestet e arsyeshme që kanë mundur të zgjidhen vetëm përmes marrëveshjes gjyqësore. Vendimet e HPCC nuk kanë mundur të lihen mënjane nga ndonjë organ administrativ (*Cooper v MB* 2003 - XII 39 EHRR 171GC), përderisa zbatimi i tyre nuk ka mundur të ndërpritet nga ndonjë institucion tjetër publik bazuar në ligj (*Van de Hurk v Holandës* A 288 (1994) 18 EHRR 48). Prandaj, duke qenë i nxjerrë me juridiksion, pas finalizimit ata kanë formuar *res judicata* (aktgjykim të Gjykatës Kushtetues në Lëndën Nr. KI.104/10 *Arsić Draža vs. Karacevo* të datës 23 prill 2012). Si çdo *res judicata* tjetër, ajo pengon vazhdimin e zgjidhjes së konfliktit nga HPCC nga udhëheqja e procedurës gjyqësore në të sipas Nenit 166, paragrafi 2, dhe Neni 391, pika d) e LPK-së që obligon gjykatat të hedhin poshtë *ex officio* padinë dubllikat, atë të fundit të përcaktuar nga HPCC në pajtim me Nenin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/23, si dhe të respektoj juridiksionin e veçantë sipas Nenit 2.5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/23. Megjithatë, kjo *res judicata* nuk është e jashtëzakonshme – ajo pengon seancën tjetër vetëm ndërmjet palëve të njëjta në lëndën e njëjtë për të lejuar formën e prerë të vendimit të HPCC-së për të mbetur i plotëfuqishëm, duke i ikur dualizmit me vendimet konfliktuoze të juridiksioneve të tjera kombëtare.

48. Në procedurë të HPCC në kërkesë DS602221 JC iu ishte aprovuar riposedimi i apartamentit në Suharekë, Rr. “Car Dušan” Nr.59, kati i II, nr.5 si posedues i saj në hipotezën e dytë të Nenit 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23. Në pajtim me bazën e rivendosjes së kësaj, Vendimi Nr. HPCC/D/ 233/2005/C dhe Vendimi Nr. HPCC/REC/76/2006 përderisa është *res judicata* ishte përcaktuese për posedim të JC që kishte mbi këtë apartament më 24 mars 1999 dhe humbjen e tij më vonë pa bartje

vullnetare sipas Nenit 1.2 (c) , hipoteza e dytë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Nenit 2.6, fjalia e parë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Këto ishin çështjet e vetme që Vendimet Nr. HPCC/D/233/2005/C dhe Nr. HPCC/REC/76/2006 janë gjykuar, definuar, jashtë kontestit, duke përjashtuar rigjykimin e tyre më tej apo shqyrtimin tjetër direkt dhe indirekt sipas Nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23. Përkundrazi, çdo çështje tjetër ndonëse të ndërlidhur me apartamentin në Suharekë, Rr. “Car Dušan” Nr.59, kati II, nr.5 nuk ishin përcaktuar nga HPCC dhe kanë mbetur jo të penguar për gjykim të ardhshëm. Që do të thotë, Vendimet Nr. HPCC/D/233/2005/C dhe Nr. HPCC/REC/76/2006 nuk janë res judicata në ndonjë të drejtë tjetër pronësore të JC që është ndryshe nga posedimi sipas Nenit 1, hipoteza e dytë apo Rregullorja e UNMIK Nr. 2000/60 është brenda alternativave tjera të përcaktuara nga Neni 1, së pari, së treti dhe hipotezat e katërta të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 – pronësi, të drejtë të banimit apo të drejtë në shfrytëzim. Nuk është formuar res judicata në posedim mbi apartamentin pas datës 18 tetor 2006 kur procedura e rishqyrtimit kundër Vendimit HPCC/D/233/2005/C ishte kompletuar nga Vendimi Nr. HPCC/REC/76/2006. Nuk mbulon res judicata dëbimin e HPD-së më 20 shkurt 2007, përfundimi i Marrëveshjes së Investimit ndërmjet Komunës së Suharekës dhe “BA” Sh.P.K. më 27 gusht 2008, demolimi i ndërtesës së vjetër në vitin 2010, ndërtimi i të resë pastaj dhe çdo fakti të ri pas datës 18 tetor 2006 – linja e kufirit për kufij të përkohshëm res judicata e Vendimeve Nr. HPCC/D/233/2005/C dhe Nr. HPCC/REC/76/2006 ka. Me fjalë të tjera, as kontesti mbi të drejtën e banimit të pretenduar nga JC siç është fituar mbi apartamentin në ndertësë të vjetër para 24 marsit 1999, e as kontesti për prejardhjen e të drejtës së kompensimit në apartament në ndertësë të re të ndërtuar pas vitit 2010 nuk është zgjidhur nga HPCC. Së këndejmi, padia e JC në C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës bazuar në faktet e prekura nga HPCC nuk e kthen kontestin e vendosur nga HPCC dhe nuk është e mbyllur në mënyrë procedurale. Res judicata e Vendimit Nr. HPCC/D/233/2005/C dhe Vendimi Nr. HPCC/REC/76/2006 paraqitur në kërkesë Nr. DS602221 të JC për riposedim të apartamentit në ndërtesën e vjetër bazuar në para posedimin e 24 marsit 1999 të humbur në konflikt në pajtim me Nenin 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 nuk koincidon në kushtet materiale dhe të përkohshme me këtë padi në C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës për kompensim me madhësi të njëjtë të apartamentit në ndertësë të re bazuar në “të drejtën e humbur” të apartamentit në ndërtesën e shkatërruar. Ky korrelacion nuk është parakusht i përsëritjes për Nenin 166, paragrafi 2 i LPK-së për t’u aplikuar. Kontesti i sjellë në vitin 2011 në Gjykatën Komunale të Suharekës nuk kthen atë të zgjidhur më herët nga HPCC në vitin 2006.

Nuk eksiston ngjashmëri në bazat faktike të dy padive dhe deklaratave të tyre. Çështja e zgjidhur nga HPCC për rivendosje të JC në posedim të apartamentit në ndërtesën e humbur si posedues i saj deri më 24 mars 1999 është ndryshe nga çështja tani e kërkuar për gjykim nga gjykata për kompensim të JC në apartament në ndërtesë të re të ndërtuar pas vitit 2010 si zotërues i të drejtës në shfrytëzim të apartamentit në ndërtesë të vjetër të shkatërruar në vitin 2010. Pa dublikim – material dhe të përkohshëm, *res judicata* e prodhuar nga Vendimet e formës së prerë Nr. HPCC/D/233/2005/C dhe Nr. HPCC/REC/76/2006 nuk është pengesë proceduralë sipas Nenit 391, pika d) LPK-së për gjykatën të zgjidh kontestin në C.nr.28/11 sipas meritave pa shkelje të mos zbërthyeshmërisë të rregullës “*non bis in idem*”.

49. Prandaj, C.nr.28/2011 e Gjykatës Komunale të Suharekës nuk është seancë e dyfishtë e krijuar pas përfundimit të lëndës HPCC Nr. DS602221 në çështjen e njëjtë lëndore. Veç kësaj, instanca e parë e procedurës gjyqësore nuk ka mundur të konsiderohet e ndërprerë në mënyrë të ligjshme sipas Nenit 166, paragrafi 2 i LPK-së për të qenë një replikë e ndaluar e procedurës së HPCC-së në DS602221. Padia në C.nr.28/11 nuk është *ex lege* e penguar nga *res judicata* e Vendimeve të HPCC Nr. HPCC/D/233/2005/C dhe Nr. HPCC/REC/76/2006; kur është nxjerrë në të aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Suharekës nuk ka mundur të jetë i palejueshëm ri zgjidhja nga HPCC sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika l) LPK. Kështu, ndalesa e pa shqyrtuar e Nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 nuk ka mundur të shkelet.

50. Duke përmbledhur të mësipërmen, padia C.nr.28/11 e Gjykatës Komunale të Suharekës nuk është *res judicata* pasi që nuk është përcaktuar përfundimisht as nga aktgjykimi C.nr.100/06 i Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006, e as nga Vendimet e HPCC-së Nr. HPCC/D/233/2005/C dhe Nr. HPCC/REC/76/2006. *Kriteri i identitetit kumulativ të palëve, identiteti i bazave faktike dhe identitetit të deklaratës së padive në këto procedura nuk është përmbushur.* Pa një dublikim të tillë, gjykimi i kontestit të ri të sjellë nuk përbën shqyrtim, ridëgjim dhe/apo ri ekzaminim të ndonjë zgjidhje të mëhershme të kontestit. C.nr.28/11 e Gjykatës Komunale të Suharekës nuk ri-nis ndonjë set të përfunduar të procedurave, e as nuk është maskim rihapje për rigjykim të çështjes së gjykuar. Në bazë të dallimeve objektive, subjektive dhe të përkohshme të paraqitura më lart, nuk ka mundur të ketë vendime kontraversale, që njëkohësisht në fuqi në kontest të njëjtë. Për shkak të kësaj divergjence, padia në C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës nuk është *res judicata*; nuk është vendosur nga ndonjë juridiksion kompetent në të kaluarën; gjykimi i saj nuk e minon pandryshueshmërinë e ndonjë vendimi final në shkelje të parimit të caktuar ligjor, inherent në Nenin 6 (1) të KEDNJ.

51. Bazuar në të gjitha më lart, gjykata e shkallës së dytë gjen Nenin 166, paragrafi 2 i LPK-së gabim të aplikuar nga gjykata e shkallës së parë pa parakushte të identitetit, të nevojshme për aplikim të tij. Kjo shkelje procedurale është *shkelja* sipas Nenit 182, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 208 të LPK-së pasi që ka rezultuar në lëshim të aktvendimit të paligjshëm për hedhje poshtë si të palejueshëm të padisë së lejueshme në kundërshtim me Nenin 166, paragrafi 2 i LPK-së.

Arsyet tjera të përfshira në ankesë

52. Të pabazuara janë arsyet e përfshira në ankesë të cilat nuk janë të ndërlidhura me Nenin 166, paragrafi 2 i LPK-së. *Në vend të parë*, aktvendimi C.nr.28/2011 i Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 30 maj 2012 duke qenë vendim procedural sipas Nenit 142, paragrafi 5 i LPK-së *nuk përmban konstatime faktike dhe përfundime ligjore sipas meritave të kontestit* që automatikisht e përjashton kundërshtimin e tij *për vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike* sipas Nenit 183 të LPK-së, si dhe *aplikimit të gabuar të ligjit material* sipas Nenit 184 të LPK-së. *Në vend të dytë*, pretendimet në ankesë në lidhje me ndarjen, shfrytëzimin dhe posedimin e apartamentit janë fakte – baza të deklaratës së padisë në C.nr.28/2011 të Gjykatës Komunale të Suharekës sipas Nenit 253, paragrafi 1, pika b) e LPK-së. Ata nuk përbëjnë baza për kundërshtimin e ligjshëmërisë së aktvendimit C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 30 maj 2013 sipas Nenit 181, paragrafi 1, pikat a)–c) në lidhje me Nenin 208 të LPK-së dhe për këtë ka mundur të ekzaminohet brenda shqyrtimit ankimor. *Në vend të tretë*, nuk është e vërtetë që Vendimi i HPCC-së Nr. HPCC/D/233/2005/C ka vërtetuar *të drejtën në shfrytëzim apo të drejtën e banimit të JC mbi apartamentin me pronësi shoqërore në Suharekë, Rr. “Car Dušan” Nr.59, kati II, nr.5.* Pasi që JC ka prezantuar vetëm fletëpagesat për qira dhe shërbime komunale dhe jo vendimin mbi ndarjen dhe/apo kontratën mbi shfrytëzim, HPCC, qartë ka deklaruar në Vendimin Nr. HPCC/D/233/2005/C (para 19), e ka njohur atë *vetëm si posedues të këtij apartamenti me posedim prej 24 marsit 1999 jo në mënyrë të manifestueshme të ligjshme* sipas Nenit 1.2 (c), hipoteza e dytë e Rregullores së UNMIK Nr.1999/23. Në të kundërtën, as shkalla e parë, e as faza e rishqyrtimit HPCC ka njohur JC si *zotërues i të drejtës së banimit të apartamentit*, sipas Nenit 1.2 (c), hipoteza e tretë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23. *Në vend të katërt*, e palejueshme në këtë shqyrtim ankimor të aktvendimit C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 30 maj 2012 janë të gjitha argumentet në ankesë që padia në C.nr.100/06 është dashur të hedhet poshtë *ex officio* nga Gjykata Komunale e Suharekës pasi që bie brenda juridiksionit ekskluziv të HPCC-së sipas Rregullores së

UNMIK-ut Nr. 1999/23. Pasi që kjo përbën shkelje procedurale substanciale sipas Nenit 354, paragrafi 2, nën paragrafi 3 i LPK-së 1977 në lëshim të aktgjykimit C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006, shqyrtimi i saj do të ishte i lejueshëm vetëm në vendosjen e *ankesës* kundër aktgjykimit të njëjtë sipas Nenit 365 të LPK-së 1977, apo mjetit juridik të jashtëzakonshëm – *rishikim* sipas Nenit 386 të LPK-së 1977 apo *mbrojtje e ligjshmërisë* sipas Nenit 408 të LPK-së 1977. Kjo bazë ligjore për kundërshtim të aktgjykimit C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006 nuk ka mundur të jetë subjekt i shqyrtimit ankimor në AC.nr.3560/12 pasi sipas Nenit 194 në lidhje me Nenin 208 të LPK-së është i kufizuar në aktvendim C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 30 maj 2012. Ky kolegji duke qenë i autorizuar për të vendosur *vetëm në ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në procedurë aktuale të shkallës së dytë* sipas Nenit 206 – 210 të LPK-së, është *pa ndonjë kompetencë për shqyrtim, të rastit apo direkt, të ndonjë vendimi tjetër gjyqësor*. Kjo është pse kolegji nuk do të konsideroj ankesën kundër aktvendimit C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 30 maj 2012 në pjesë në të cilën ajo është *ankesë në fshehje* kundër aktgjykimit C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006. Në vend të *pestë*, në procedurë të HPCC-së në kërkesën Nr. DS602221 të JC, GA kanë marrë pjesë si *të paditur* me kundërshtime që korrespondojnë me kualifikimin ligjor të padisë në Nenin 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23. Bazuar në pranimin e GA dhe pas verifikimit në Ndërmarrje Publike Banesore – Suharekë, HPCC e ka mbajtur mbrojtjen e saj si jo të vlefshme *as për banim jo të ligjshëm* të apartamentit, por për *humbje të posedimit të tij shumë para datës 24 mars 1999* (Vendimi Nr. HPCC/D/233/2005/C, paragraf 19). Në vend të *gjashtë*, më 19 janar 2007 GA ka parashtruar kërkesë të dytë për rishqyrtim në HPCC, duke paraqitur një kopje të vërtetuar të aktgjykimit të formës së prerë C.nr.100/06 të Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006. Ishte refuzuar nga letra e HPD-së, e datës 5 shkurt 2007 mbi *baza procedurale* me arsyetim që prej Nenit 14.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2000/60 lejon për *vetëm një* kërkesë rishqyrtuese nga pala në padi, GA kishte shfrytëzuar këtë mjet juridik me kërkesë të tij të parë, të datës 31 mars 2006, dhe kërkesës së tij shtesë, të datës 19 janar 2007 nuk mund të procesohet më tej. Në vend të *shtatë*, me të vërtetë sipas Nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 vendimet përfundimtare të HPCC janë detyruese dhe të zbatueshme, dhe nuk i nënshtrohen ndonjë rishikimi nga ndonjë autoritet tjetër gjyqësor apo administrativ i Kosovës. Këto efekte juridike megjithatë janë saktë të kufizuara në zgjidhjen e kontestit përfundimtar ndërmjet palëve në procedurë të HPCC-së dhe *anasjelltasi* nuk

janë paraqitur jashtë këtyre kufijve. Neni 2.7 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 nuk aprovon vlerën universale juridike apo dëshmuese të vendimeve përfundimtare të HPCC-së, e as nuk e vërtetën epërsinë mbi aktet e të gjithë organeve tjera kombëtare dhe juridiksonet. Rrjedhimisht, Vendimet e HPCC-së Nr. HPCC/D/233/2005/C dhe Nr. HPCC/REC/76/2006 janë detyruese dhe të zbatueshme dhe nuk i nënshtrohen ndonjë shqyrtimi nga *autoriteti tjetër vetëm sa i përket riposedimit të aprovuar JC si person i cili kishte apartamentin në posedim të tij më 24 mars 1999, dhe ka humbur atë së fundi* në pajtim me Nenin 1.2 (c), hipoteza e dytë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23. Në anën e kundërt, *kjo e drejtë e riposedimit nuk iu ishte njohur atij si zotërues i të drejtës së banimit të apartamentit sipas Nenit 1.2 (c), hipoteza e tretë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23. Vendimet e HPCC-së Nr. HPCC/D/233/2005/C dhe Nr. HPCC/REC/76/2006 nuk kanë zgjidhur kontestin mbi pronësinë, të drejtën e banimit apo të drejtën mbi apartamentin e sipërpërmendur dhe janë me efekt ligjor zero sipas Nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 në lidhje me këtë çështje. Veç kësaj, nuk janë të vërtetuar argumentet në ankesë që Vendimet e përmendura të HPCC-së janë prova të vetme me vlerën testuese ekskluzive që mund të shërbejnë si bazë e duhur ligjore për zgjidhje të kontestit në C.nr.28/11 të Gjykatës Komonale të Suharekës.*

IV. KONKLuzionet. SHPENZimet e PROCEDURALE

53. Bazuar në shqyrtimet e mësipërme, gjykata e shkallës së dytë e miraton ankesën – aktvendimin C.nr.28/11 të Gjykatës Komonale të Suharekës, të datës 30 maj 2012 të anulohet për shkelje të vërtetuar procedurale të Nenit 182, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 166, paragrafi 2 i LPK-së me kthim të lëndës në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim sipas Nenit 209, pika d) e LPK-së.

54. Padia në C.nr.28/11 e Gjykatës Komonale të Suharekës nuk është *res judicata* dhe duhet të ekzaminohet dhe vendoset sipas meritave në procedurë të rregullt të shkallës së parë, duke inkorporuar një grup të tërë të garantuesve procedural për të gjitha palët. *Në vend të parë*, në pajtim me Nenin 5, paragrafi 1 i LPK-së paditësit duhet t'i ofrohet rasti i kërkuar por jo të lejohet në seancë më 30 maj 2012 të paraqes me shkrim kundër argumentet e tija në përgjigje të të paditurve, të dorëzuara atij në seancë të njëjtë. *Në vend të dytë*, paditësit duhet t'i kërkohet të korrigjoj dhe të kompletoj padinë në pajtim me Nenin 102, paragrafi 1 i LPK-së duke specifikuar *bazën për fitim të së drejtës së banimit të pretenduar apartamentin në Suharekë, Rr. "Car Dušan" Nr.59, kati i II, nr.5 si vendim konkret mbi ndarjen dhe kontratën në shfrytëzim; Vendimet Nr.HPCC/D/233/2005/C dhe Nr. HPCC/REC/76/2006 nuk janë*

paraqitur me ligj si një bazë e tillë e përvetësuar. Konkretizimi nevojitet gjithashtu te tipet e *dëmeve* të shkaktuar nga shkatërrimi i vitit 2010 të ndërtesës dhe *bazë për kompensim të tyre* – vet ligji, një akt i institucionit kompetent publik apo transaksion ligjor. Neni 8 i KEDNJ ka cituar në padi pasi që baza e tij garanton në paragrafin 1 “*e drejta për të respektuar banimin*” kundër interferencave të autoriteteve publike, njëjtë për përjashtimet e paraqitura në paragrafin 2, por *nuk parasheh kompensimin për ndërhyrjet e pa justifikuara, përfshirë shkatërrimin e shtëpisë*. Gjithashtu, asnjë kompensim real me madhësi të njëjtë të apartamentit nuk ka mundur të arsyetohet me Nenin 8 të KEDNJ pasi që sipas KEDNJ kjo dispozitë nuk garanton as “*të drejtën e ofrimit me banesë*”, e as “*të drejtën e gëzimit me banesë në standard të veçantë*” (*Chapman vs. UK 2001-I; 33 ECRR 399*). Në vend të tretë, kur e drejta e pretenduar rrjedh apo përndryshe varet nga një e drejtë tjetër e përcaktuar në procedurë të mëhershme, gjykata në kontestin në pritje është e obliguar të pranoj si përcaktim të saj këtë *res judicata* dhe të procedoj nga baza e saj në lidhje me personat – të adresuarit e tij pa re-ekzaminim apo ri-zgjidhje të çështjeve të dëmshme – çështjes së saj lëndore. Kjo njohje (lidhje) për shkak të *res judicata* objektit dhe ruan atë, por nuk duhet të barazohet në vet *res judicata*. Më tej, sa i përket *res judicata* është e vlefshme vetëm në kufijtë e caktuar objektiv dhe subjektiv, *njohja e saj është e lejueshme pas identitetit të çështjes lëndore dhe të adresuarit me raport juridik paragjyqësor* sipas Nenit 13, paragrafi 1 i LPK-së. Këtu *e drejta në kompensim me banesën ekuivalente në ndërtesën e re të pretenduar nga JC në C.nr.28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës është nxjerrë në dëm nga e drejta e banimit mbi apartamentin në ndërtesën e demoluar*. Duke pasur parasysh kufijtë, *res judicata* e aktgjykimit në C.nr.100/06 e Gjykatës Komunale të Suharekës, të datës 19 maj 2006 nuk ka mundur të merret parasysh sa i përket *zotëruesit të së drejtës së banimit/të drejtës në shfrytëzim mbi apartamentin e demoluar* pasi që ai nuk ka efekt juridik kundër JC sipas Nenit 167, paragrafi 1 i LPK-së. Në mënyrë të barabartë, nuk është e mundshme një njohje e tilë për *res judicata* të Vendimeve të HPCC-së Nr. HPCC/D/233/2005/C dhe Nr. HPCC/REC/76/2006, të formuara në *posedimin* e humbur të para 24 marsit 1999 të JC mbi apartamentin dhe jo të formuara *mbi të drejtën e banimit/ të drejtën në shfrytëzim mbi këtë pronë*. Prandaj, në gjykim të C.nr. 28/11 të Gjykatës Komunale të Suharekës pas heqjes së saj në gjykatë të shkallës së parë të gjitha palëve duhet të ju jepet rast i barabartë për të sjellur të gjitha provat relevante në dispozicion; *inter alia*, JC dhe GA të paraqesin vendimet përkatëse mbi ndarjen dhe kontratat mbi shfrytëzim *sa i përket të drejtës së banimit* mbi apartamentin me pronësi shoqërore në ndërtesën e demoluar si paragjyqësor për *të drejtën e zotëruesit të tij për tu kompensuar me apartamentin*

në ndërtesën e re të ndërtuar. Pastaj kolegji do të shqyrtoj në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të kujdesshme çdo provë të mbledhur ndarazi dhe si tërësi në përputhje me Nenin 8 të LPK-së, dhe aplikon rregullat e peshës së provave sipas Nenit 322 të LPK-së për faktet që nuk janë dëshmuar në mënyrë të sigurt.

55. Pasi që aktvendimi i ankimuar është anuluar me kthim të lëndës për rigjykim, shpenzimet e procedurës e bëra në këtë ankesë në pajtim me Nenin 465, paragrafi 3 i LPK-së do të caktohen në vendimin përfundimtar.

Në bazë të arsyetimit të sipërpërmendur është vendosur si në dispozitiv.

MJETI JURIDIK: Nuk lejohet ankesë kundër këtij aktvendimi në pajtim me Nenin 206, paragrafi 1 *in fine* në lidhje me Nenin 176, paragrafi 1, fjalia e parë dhe Neni 210 e LPK-së.

**GJYKATA E APELIT – PRISHTINË
AC.nr.3560/2012 më 05.12.2013**

KRYETARJA E KOLEGJIT ROSITZA BUZOVA

E hartuar në Anglisht si Gjuhë zyrtare në pajtim me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

SHËNIM MBI SEANCËN E SHQYRTIMIT DHE VOTIMIT

GJYKATA E APELIT, si shkallë e dytë, në përbërje të gjyqtarëve civile të EULEX-it ROSITZA BUZOVA, kryetare e trupit gjykues, gjyqtari kosovar MUHAMED REXHA dhe gjyqtari kosovar MUHARREM SHALA, si anëtar i trupit gjykues, në seancën përmbyllëse me 5 dhjetor 2013 kanë shqyrtuar dhe votuar unanimisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ky shënim i bashkëngjitet aktvendimit AC.nr.3560/12 të Gjykatës së Apelit të datës 5 dhjetor 2013 sipas nenit 140, para 1, fjalia e dytë e LPK-së.

GJYKATA E APELIT - PRISHTINË

AC.nr.3560/2012 me 05.12.2013

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES ROSITZA BUZOVA

**GJYQTARI MUHAMED REXHA
ANËTARI I TRUPIT GJYKUES**

**GJYQTARI MUHARREM SHALA
ANËTARI I TRUPIT GJYKUES**

**ANDERS MORENO
Zyrtar Ligjor i EULEX-it**

**DAUT LATIFAJ
INTERPRET/PERKTHYES I EULEX-it (ANGLISHT-SHQIP)**

I përpiluar në gjuhën angleze si gjuhë zyrtare sipas nenit 17 të Ligjit nr.03/L-053 për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe i nënshkruar nga gjyqtarët kosovarë pas përkthimit nga përkthyesit e cekur më lartë.